



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 213

Tiranë – E Martë, 20 Janar 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 68, datë 18.12.2014	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Procredit sh.a..... 12777
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 69, datë 18.12.2014	Për miratimin e rregullores “Për kapitalin rregullator të Bankës”..... 12777
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 70, datë 18.12.2014	Për disa ndryshime në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”..... 12806
	Korrigjim gabimi..... 12809

**VENDIM****Nr. 68, datë 18.12.2014****PËR DHËNIEN E MIRATIMIT
PARAPRAK PËR KRYERJEN E
VEPRIMTARISË SHITESË NGA BANKA
PROCREDIT SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe të nenit 13 të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga “Banka ProCredit” sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:

a) Tregtimin për llogari të saj, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, të letrave me vlerë të transferueshme.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së “Bankës ProCredit” sh.a., pas kryerjes së ndryshimit, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDESKRYETARI
Elisabeta Gjoni

VENDIM**Nr. 69, datë 18.12.2014****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KAPITALIN RREGULLATOR TË
BANKËS”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 59, pika 2, dhe 8, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Statistikave në Bankën e Shqipërisë, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Bankat, deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, marrin masat dhe krijojnë kushtet e nevojshme për zbatimin e kërkesave të rregullores, si dhe raportojnë në Bankën e Shqipërisë, në lidhje me ecurinë e marrjes së masave, sipas kërkesave të Departamentit të Mbikëqyrjes.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 57, datë 5.5.1999, “Për miratimin e udhëzimit “Për kapitalin rregullator të bankës”, i ndryshuar, dhe vendimi nr. 51, datë 22.4.1999, “Për miratimin e rregullores “Për madhësinë dhe plotësimin e kapitalit fillestar minimal për veprimtaritë e lejuara për bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara”.

5. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 31 mars 2015.

ZËVENDESKRYETARI
Elisabeta Gjoni

RREGULLORE**PËR KAPITALIN RREGULLATOR TË
BANKËS****KREU I
TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i strukturës, elementeve përbërës dhe metodës së llogaritjes së kapitalit rregullator të bankës dhe përcaktimit të nivelit minimal të tij.

Neni 2**Baza juridike**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) nenit 59, pika 2 dhe 8, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili më poshtë në këtë rregullore do të quhet ligji për bankat.

Neni 3**Subjektet**

1. Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat e licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 4**Përkufizimet**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” (këtu e më poshtë, për thjeshtësi, rregullorja e mjaftueshmërisë së kapitalit), si dhe në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të autorizuar nga ministri i Financave.

2. Përveç sa parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Aktive tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme” - janë aktivet tatimore të shtyra, vlera e ardhshme e të cilave mund të realizohet vetëm në rast se banka gjeneron të ardhura të tatueshme në të ardhmen;

b) “Aktive të fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar” - janë aktivet e një fondi ose plani të përcaktuar pensionesh, të përlogaritura pasi janë reduktuar me shumën e detyrimeve nën të njëjtin fond ose plan;

c) “Pjesëmarrje reciproke (e kryqëzuar)” - është çdo pjesëmarrje e bankës në instrumentet e kapitalit rregullator ose instrumente të tjera kapitali të emetuara nga subjektet e sektorit financiar, kur edhe këto subjekte kanë pjesëmarrje në instrumente të kapitalit rregullator të emetuara nga banka;

d) “Pjesëmarrje sintetike” - janë investimet e bankës në instrumente financiare vlera e të cilave lidhet drejtpërdrejt me vlerën e instrumenteve të kapitalit të emetuara nga një subjekt i sektorit financiar;

e) “Investim i rëndësishëm i bankës në një bankë ose subjekt tjetër financiar” - është çdo investim që plotëson një nga kushtet e mëposhtme:

i) banka zotëron më shumë se 10% të instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë të emetuar nga banka tjetër ose subjekti;

ii) banka ka lidhje të ngushta me bankën tjetër ose subjektin financiar dhe zotëron instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë të emetuar nga ky i fundit;

iii) banka zotëron instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë të emetuar nga banka tjetër ose subjekti financiar dhe ky i fundit nuk përfshihet në perimetrit e konsolidimit sipas kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi për mbikëqyrjen e konsoliduar, por përfshihet në të njëjtin konsolidim kontabël si banka për qëllime të raportimit financiar sipas standardeve kontabël në fuqi.

3. Bankat, në rastet kur “Metodologjia e raportimit dhe përmbajtjes së raporteve financiare” nuk parashikon zërat e bilancit dhe të pasqyrave financiare sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, do të zbatojnë kërkesat lidhur me zërat e përcaktuar në këtë rregullore në momentin e hyrjes në fuqi të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit edhe për qëllime të raportimit në

Bankën e Shqipërisë (sipas Sistemit Raportues të Unifikuar).

KREU II KAPITALI RREGULLATOR

Neni 5 Struktura

1. Kapitali rregullator është kapitali i bankës, i llogaritur sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, për mbulimin e rrezikut të kredisë, të rreziqeve të tregut dhe të rrezikut operacional.

2. Kapitali rregullator i bankës, në varësi të karakteristikave të tij dhe të kushteve të përcaktuara në këtë rregullore, ndahet në dy kategori:

- a) kapitali i nivelit të parë;
- b) kapitali i nivelit të dytë.

3. Bankat llogarisin kapitalin rregullator të saj si shumë të kapitalit të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë, duke marrë në konsideratë edhe zbritjet sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe/ose të akteve të tjera rregullative.

NËNKREU I KAPITALI I NIVELIT TË PARË

Neni 6 Struktura dhe elementet përbërëse

1. Bankat llogarisin kapitalin e nivelit të parë si shumë të kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit shtesë të nivelit të parë, duke marrë në konsideratë edhe zbritjet sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe/ose të akteve të tjera rregullative.

2. Kapitali bazë i nivelit të parë përbëhet nga elementet e mëposhtme:

- a) kapitali i paguar (aksione të zakonshme);
- b) primet e aksioneve (të zakonshme);
- c) fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme;
- d) fitimi ushtrimor i fundit të vitit;
- e) fitimi ushtrimor i periudhës raportuese;
- f) rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit);
- g) diferenca rivlerësimi kreditore.

3. Niveli i kapitalit bazë të nivelit të parë duhet të jetë në çdo kohë më i madh se niveli i kapitalit fillestar minimal të kërkuar.

4. Kapitali i paguar përbëhet vetëm nga aksionet e zakonshme, të cilat mbartin të gjitha karakteristikat sipas përcaktimeve në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

5. Rezervat, me përjashtim të rezervave të rivlerësimit¹, krijohen nga shpërndarja e fitimit të bankës pas zbritjes së tatimit dhe përpara shpërndarjes së dividendëve. Rezervat krijohen me vendim të organeve vendimmarrëse, në zbatim të akteve rregullative të brendshme të bankës, si dhe të kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi.

6. Rezervat e përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni përfshijnë kategoritë e mëposhtme të rezervave:

- a) rezervat ligjore, të krijuara në zbatim të akteve ligjore dhe rregullative në fuqi;
- b) rezervat statutorë, të krijuara në zbatim të përcaktimeve të statutit të bankës;
- c) rezervat e tjera, të cilat përfaqësojnë të gjitha rezervat e tjera të krijuara nga shpërndarja e fitimit, me përjashtim të rezervave të shkronjave “a” dhe “b” të këtij paragrafi.

Në rezervat e tjera, përfshihen edhe rezervat e përgjithshme, të cilat krijohen nga banka në masën 1.25 për qind deri në 2 për qind të totalit të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të ponderuara me rrezikun. Këto rezerva krijohen duke zbritur një të pestën e fitimit të bankës² dhe përdoren lirisht nga banka me qëllim mbulimin e rreziqeve të paidentifikuara në veprimtarinë e saj dhe nuk pasqyrojnë reduktimin e vlerës së një aktivi të caktuar. Bankat, në rastet kur fondi rezervë i krijuar bie nën nivelin minimal të kërkuar, është e detyruar ta plotësojë atë brenda një afati kohor 2 (dy) -vjeçar.

7. Fitimet e pashpërndara, të cilat janë të lira nga çdo detyrim i ardhshëm, përfshihen në kapitalin bazë të nivelit të parë të bankës, vetëm me miratimin e asamblesë së përgjithshme për pjesën që parashikohet të jetë element përbërës i tij.

8. Bankat përfshijnë fitimin e periudhës raportuese, si element të kapitalit bazë, vetëm nëse plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

- a) është miratuar nga ekspertitë kontabël i autorizuar i bankës;
- b) është zbritur çdo dividend i ndërmjetëm (pjesëshëm) i paguar gjatë vitit, taksat dhe detyrimet e tjera mbi fitimin.

¹ Rezervat e rivlerësimit përfaqësojnë kundërpartinë e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme, në kuadrin e rivlerësimeve vullnetare (ose të kërkuara ligjërisht) të bëra nga banka, me qëllim që të korrektohet vlera bartëse e mjeteve të saj për efekt të inflacionit.

² Pas zbritjes së tatimit dhe përpara shpërndarjes së dividendëve.



Bankat paraqesin pranë Bankës së Shqipërisë dokumentet përkatëse, të cilët evidentojnë plotësimin e kushteve të përcaktuara më sipër.

NËNKREU II FILTRAT PRUDENCIALË

Neni 7

Aktivët e titullzuara

1. Bankat nuk përfshijnë në kapitalin e tyre rregullator çdo rritje në vlerën e kapitalit aksioner që rezulton nga aktivët e titullzuara, të tilla si:

- a) rritjet në të ardhurat e pritshme për bankën nga marzhi i fitimit nga shitja;
- b) fitimet neto, në rastet kur banka është origjinuese e një titullzimi, që burojnë nga kapitalizimi i të ardhurave të ardhshme nga aktivët e titullzuara që sigurojnë përmirësim të cilësisë së kredisë për pozicionet e titullzimit.

Neni 8

Rezervat e mbrojtjes së flukseve të parasë dhe ndryshimet në vlerën e detyrimeve të veta

1. Bankat nuk përfshijnë në asnjë element të kapitalit të tyre rregullator zërat e mëposhtëm:

- a) rezervat e vlerës së drejtë që lidhen me fitimet ose humbjet nga mbrojtjet e flukseve të parasë të instrumenteve financiare që nuk vlerësohen me vlerën e tyre të drejtë (*fair value*), përfshirë flukset e projektuara të parasë;
- b) fitimet ose humbjet nga detyrimet e bankës që vlerësohen me vlerë të drejtë, që rezultojnë nga ndryshimet në vlerësimin e kredisë (*credit rating*) të vetë bankës;
- c) të gjitha fitimet dhe humbjet e vlerës së drejtë, që burojnë nga rreziku i kredisë së vetë bankës, lidhur me detyrimet derivative.

2. Bankat, për qëllime të shkronjës “c” të paragrafit 1 të këtij neni, nuk kompensojnë fitimet dhe humbjet e vlerës së drejtë, që burojnë nga rreziku i kredisë së vetë bankës, me ato që burojnë nga rreziku i kundërpartisë.

3. Bankat, duke bërë përjashtim nga kërkesat e shkronjës “b” të paragrafit 1 të këtij neni, mund të përfshijnë në kapitalin e tyre rregullator shumën e fitimeve dhe humbjeve nga detyrimet e tyre kur ndryshimet në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të bankës burojnë nga të njëjtat ndryshime në vlerësimin e kredisë së vetë bankës (*credit rating*).

Neni 9

Rregullime të tjera të vlerës

1. Bankat zbatojnë kërkesat e nenit 142 “Kërkesa për vlerësimin e zërave të librit të tregtueshëm”, të rregullores për mjaftueshmërinë e kapitalit, për të gjitha aktivët e matura me vlerën e drejtë (*fair value*) gjatë përlogaritjes së kapitalit rregullator, dhe zbresin nga kapitali bazë i nivelit të parë shumën e çdo rregullimi vlere shtesë që mund të jetë i nevojshëm.

Neni 10

Fitimet dhe humbjet e parealizuara të matura me vlerë të drejtë

1. Bankat, përveç rastit të zërave të përcaktuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje, nuk përjashtojnë nga kapitali rregullator fitimet ose humbjet e parealizuara nga aktivët ose detyrimet e matura me vlerë të drejtë.

NËNKREU III

ZBRITJET NGA KAPITALI BAZË I NIVELIT TË PARË

Neni 11

Zbritjet nga zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë

1. Bankat zbresin nga zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë, elementet e mëposhtme:

- a) humbjet e periudhës raportuese;
- b) aktivët e patrupëzuara;
- c) aktivët tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme;
- d) aktivët e fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar, që ndodhen në bilancin e bankës;
- e) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të bankës në instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë, përfshirë instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë që banka është e detyruar të blejë në bazë të një detyrimi aktual apo të mundshëm që buron nga një marrëdhënie kontraktore ekzistuese;
- f) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar në rastet kur këto subjekte kanë pjesëmarrje të kryqëzuara



(reciproke) me bankën, të cilat Banka e Shqipërisë vlerëson se janë krijuar për të rritur artificialisht kapitalin rregullator të bankës;

g) shumën e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të bankës në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë, ku banka nuk ka investime të rëndësishme në subjektet e sektorit financiar;

h) shumën e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të bankës në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investime të rëndësishme;

i) shumën e zërave që kërkohet të zbriten nga zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë në përputhje me nenin 26 të kësaj rregulloreje, që tejkalon nivelin e kapitalit shtesë të nivelit të parë të bankës;

j) shumën e ekspozimit të zërave të mëposhtëm, të cilët kualifikohen për një peshë rreziku prej 1250%, në rastet kur banka e zbret këtë shumë ekspozimi nga shuma e zërave të kapitalit bazë të nivelit të parë si alternativë ndaj zbatimit të një peshe rreziku prej 1250%:

i) pjesëmarrjet influencuese (*qualifying holding*) jashtë sektorit financiar;

ii) pozicionet e titullimit në përputhje me nenin 103, paragrafi 1, shkronja “b”, nenin 104, paragrafi 1, shkronja “b” dhe nenin 123 të rregullores për mjaftueshmërinë e kapitalit;

iii) ekspozimet joDVP (*free delivery*), sipas nenit 164, paragrafi 3, të rregullores për mjaftueshmërinë e kapitalit;

k) çdo shpenzim tatimor që lidhet me zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë, të parashikueshëm në momentin e përlogaritjes, përveç rasteve kur banka rregullon shumën e zërave të kapitalit bazë të nivelit të parë në mënyrë të tillë që këto shpenzime të reduktojnë shumën deri në të cilën këta zëra (të kapitalit) mund të përdoren për të mbuluar rreziqet apo humbjet.

2. Bankat, për zbritjen e zërave të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, zbatojnë kërkesat e përcaktuara në nenet 12 deri 20 të kësaj rregulloreje.

Neni 12

Zbritja e aktiveve të patrupëzuara

1. Bankat zbresin aktivet e patrupëzuara nga kapitali bazë i nivelit të parë.

2. Bankat përlogarisin shumën e aktiveve të patrupëzuara që duhet të zbritet në përputhje me përcaktimet e mëposhtme:

a) shuma që do të zbritet do të reduktohet me shumën e detyrimeve tatimore të shtyra të lidhura me aktivet e patrupëzuara, që do të fshiheshin nëse aktivet e patrupëzuara do të zhvlerësoheshin ose fshiheshin nga bilanci;

b) shuma që do të zbritet do të përfshijë emrin e mirë (*goodwill*) që rezulton nga vlerësimi i investimeve të rëndësishme të bankës.

Neni 13

Zbritjet e aktiveve tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme

1. Bankat zbresin nga kapitali bazë i nivelit të parë aktivet tatimore të shtyra, realizimi i të cilave varet nga përfitueshmëria e ardhshme e bankës.

2. Bankat netojnë aktivet tatimore të shtyra me pasivet tatimore të shtyra vetëm nëse plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) banka ka të drejtë të netojë aktivet tatimore korrente me detyrimet tatimore korrente në bazë të kuadrit ligjor;

b) aktivet tatimore të shtyra dhe pasivet tatimore të shtyra lidhen me taksa të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor dhe mbi të njëjtin subjekt tatimor.

3. Bankat, nuk mund të përdorin për qëllime të paragrafit 2 të këtij neni, pjesën e detyrimeve të shtyra tatimore që është përdorur për të reduktuar vlerën e aktiveve të patrupëzuara ose aktiveve të fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar, që duhet të zbriten nga kapitali bazë i nivelit të parë.

4. Shuma e detyrimeve tatimore të shtyra të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, do të shpërndahet ndërmjet zërave të mëposhtëm:

a) aktiveve tatimore të shtyra, që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme që nuk zbriten në përputhje me nenin 20, paragrafi 1, të kësaj rregulloreje;

b) të gjitha aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme.

5. Bankat shpërndajnë pasivet tatimore të shtyra në përputhje me peshën e aktiveve tatimore të shtyra që mbështeten në përfitueshmërinë e ardhshme që përcaktohen në shkronjat “a” dhe “b” të paragrafit 4 të këtij neni.



Neni 14

Mbipagesat e taksave, mbartja e humbjeve tatimore në periudhat e kaluara dhe aktivet tatimore të shtyra që nuk mbështeten në përfitueshmërinë e ardhshme

1. Bankat nuk zbresin nga kapitali bazë i nivelit të parë, por ponderojnë me peshat përkatëse me rrezik sipas përcaktimeve të rregullores mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, zërat e mëposhtëm:

- a) mbipagesat e taksave për vitin korrent;
- b) humbjet tatimore të vitit korrent të mbartura në periudhat e kaluara prej të cilave buron një pretendim ose një zë i arkëtueshëm ndaj qeverisë qendrore ose organeve të qeverisjes vendore.

2. Bankat do të konsiderojnë si aktive tatimore të shtyra që nuk varen nga përfitueshmëria e ardhshme, vetëm ato aktive tatimore të shtyra që burojnë nga diferencat e përkohshme dhe përmbushin të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) aktivet tatimore të shtyra zëvendësohen automatikisht dhe detyrimisht pa vonesë me një kredit/të ardhur tatimore në rast se banka raporton humbje në momentin e miratimit formal të pasqyrave financiare vjetore ose në rast likuidimi ose paaftësie paguese të saj (bankës);

b) bankat, në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi do të jenë në gjendje të netojnë kreditin/të ardhurën tatimore të përcaktuar në shkronjën “a” të këtij paragrafi me çdo detyrim tatimor të saj ose të çdo subjekti tjetër të përfshirë në të njëjtin perimetër konsolidimi me të për qëllime tatimore ose të çdo subjekti tjetër që i nënshtrohet mbikëqyrjes së konsoliduar;

c) në rastet kur shuma e krediteve/të ardhurave tatimore të referuara në shkronjën “b” të këtij paragrafi tejkalon shumën e detyrimeve të saj tatimore, çdo teprice e tillë zëvendësohet pa vonesë me një pretendim të drejtpërdrejtë ndaj qeverisë qendrore.

Bankat zbatojnë një peshë rreziku prej 100% për aktivet tatimore të shtyra kur plotësohen kushtet e specifikuar në shkronjat “a” deri në “c” të këtij paragrafi.

Neni 15

Zbritja e aktiveve të fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar

1. Bankat zbresin nga kapitali bazë i nivelit të parë aktivet e fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar që ndodhen në bilancin e tyre.

2. Bankat reduktojnë shumën e aktiveve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, me zërat e mëposhtëm:

a) shumën e çdo pasivi tatimor të shtyrë, i cili mund të fshihet nëse aktivet zhvlerësohen ose fshihen nga bilanci;

b) shumën e aktiveve në fondet e pensionit me përfitim të përcaktuar, të cilat banka ka aftësi të pakufizuar për t'i përdorur, me kusht që banka të ketë marrë paraprakisht miratimin e Bankës së Shqipërisë. Aktivet, që do të përdoren për të reduktuar shumën e aktiveve të zbritshme nga kapitali, do të ponderohen me peshat përkatëse me rrezik sipas përcaktimeve të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

Neni 16

Zbritja e pjesëmarrjeve në instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë

1. Bankat, zbresin nga kapitali bazë i nivelit të parë, pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë, duke përfshirë instrumentet e kësaj kategorie, që ato janë të detyruara të blejnë në bazë të një detyrimi ekzistues ose të mundshëm që buron nga një kontratë ekzistuese.

2. Bankat përcaktojnë pjesëmarrjen në instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë, në bazë të pozicioneve në blerje bruto, duke bërë përjashtimet e mëposhtme:

a) bankat mund të përllogarisin shumën e pjesëmarrjes në instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë në bazë të pozicioneve në blerje neto, me kusht që të plotësohen njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

i) pozicionet në blerje dhe ato në shitje të jenë në të njëjtin ekspozim bazë dhe pozicionet në shitje nuk bartin rrezik kundërpattie;

ii) pozicionet në blerje dhe ato në shitje duhet të jenë kontabilizuar së bashku në librin e tregtueshëm ose së bashku në librin e bankës;



b) bankat përcaktojnë shumën që do të zbritet lidhur me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të letrave me vlerë të indekseve, duke përllogaritur ekspozimin bazë ndaj instrumenteve të veta të kapitalit bazë të nivelit të parë të përfshira në ato indekse;

c) bankat mund të netojnë pozicionet në blerje bruto në instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë që rezultojnë nga pjesëmarrjet në letra me vlerë të indekseve me pozicionet në shitje në instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë, që rezultojnë nga pozicionet në shitje në indekset bazë, përfshirë rastet kur këto pozicione në shitje bartin rrezik kundërpattie, me kusht që të përmbushen të dyja kriteret e mëposhtme:

i) pozicionet në blerje dhe në shitje të jenë në të njëjtin indeks bazë;

ii) pozicionet në blerje dhe ato në shitje duhet të jenë kontabilizuar së bashku në librin e tregtueshëm ose së bashku në librin e bankës.

Neni 17

Zbritja e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar, ku banka ka pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) të krijuara për të rritur artificialisht kapitalin

1. Bankat zbresin nga kapitali bazë i nivelit të parë pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të bankave dhe subjekteve të tjera financiare kur këto subjekte kanë pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) me bankën, të cilat Banka e Shqipërisë vlerëson se janë krijuar për të rritur artificialisht kapitalin e bankës.

2. Bankat zbresin pjesëmarrjet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) pjesëmarrjet në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe instrumentet e tjera të bankave dhe subjekteve të tjera financiare do të përllogariten në bazë të pozicioneve bruto në blerje;

b) për qëllime të kësaj zbritjeje, zërat që i përkasin kapitalit bazë të shoqërive të sigurimit do të trajtohen si pjesëmarrje në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të bankës.

Neni 18

Zbritjet e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë, ku banka nuk ka investime të rëndësishme në subjekte të sektorit financiar

1. Bankat zbresin nga kapitali bazë i nivelit të parë, shumën e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë të bankave dhe subjekteve të tjera financiare ku banka nuk ka investime të rëndësishme, siç përcaktohet më poshtë në këtë nen.

2. Bankat përllogarisin pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë të bankave dhe subjekteve të tjera financiare, në bazë të pozicionit neto në blerje në të njëjtin ekspozim bazë, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) maturiteti i pozicionit në shitje përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose ka një maturitet të mbetur prej të paktën një viti;

b) pozicionet në blerje dhe në shitje duhet të jenë kontabilizuar së bashku në librin e tregtueshëm ose së bashku në librin e bankës.

3. Bankat përcaktojnë shumën që do të zbritet në lidhje me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të letrave me vlerë të indekseve, duke përllogaritur ekspozimin bazë ndaj instrumenteve të kapitalit të bankave dhe subjekteve të tjera financiare në ato indekse.

4. Bankat zbresin nga kapitali bazë i nivelit të parë, shumën që përllogaritet si produkt i shumëzimit të vlerës së përcaktuar në shkronjën “a” me faktorin e përcaktuar në shkronjën “b” të këtij paragrafi:

a) shuma agregate për të cilën pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të bankës në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë, kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë të bankave dhe subjekteve të tjera financiare ku banka nuk ka investime të rëndësishme, tejkalojnë 10% të shumës së kapitalit bazë të nivelit të parë. Për qëllime të kësaj pike, si shumë e kapitalit bazë të nivelit të parë do të konsiderohet ajo që rezulton pas:

i) zbatimit të neneve 7 deri në 10 të kësaj rregulloreje;



ii) zbritjeve të përcaktuara në nenin 11, paragrafi 1, shkronjat “a” deri në “f”, shkronja “j”, nënpikat (ii) dhe (iii), dhe shkronjën “k”, duke përjashtuar shumën e zbritshme lidhur me aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme;

b) shuma e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të bankës në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të bankave dhe subjekteve të tjera financiare, ku banka nuk ka investime të rëndësishme, pjesëtuar me shumën agregate të pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të bankës në instrumentet e kapitalit të vet të këtyre bankave dhe subjekteve të tjera financiare.

5. Bankat përjashtojnë nga shuma e përcaktuar në shkronjën “a” të paragrafit 4 të këtij neni dhe nga përlogaritja e faktorit të përcaktuar në shkronjën “b” të po atij paragrafi, pozicionet e nënshkrimit³ të mbajtura për 5 ose më pak ditë pune.

6. Bankat e shpërndajnë shumën që duhet të zbritet në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, midis të gjitha instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë që ajo mban. Bankat përcaktojnë peshën e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë që zbritet në përputhje me paragrafin 4, duke shumëzuar shumën e përcaktuar në shkronjën “a” të këtij paragrafi, me peshën e përcaktuar në shkronjën “b” të po këtij paragrafi:

a) shuma e pjesëmarrjeve që duhet të zbritet në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni;

b) pesha e çdo instrumenti të kapitalit bazë të nivelit të parë të bankave dhe subjekteve të tjera financiare ku banka ka pjesëmarrje të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike jo influencuese, ndaj shumës agregate këtyre pjesëmarrjeve.

7. Bankat nuk zbresin shumën e pjesëmarrjeve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, që është e barabartë ose më pak se 10% e kapitalit bazë të nivelit të parë të bankës pas zbatimit të kërkesave të nënpikave “i” dhe “ii” të shkronjës “a” të paragrafit 4 të këtij neni, por ponderojnë këto të fundit me peshat e rrezikut sipas kërkesave të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

8. Bankat përcaktojnë pjesën e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit të vet, që ponderohet me rrezik, duke pjesëtuar shumën e përcaktuar në shkronjën “a” me shumën e përcaktuar në shkronjën “b” të këtij paragrafi:

a) shuma e pjesëmarrjeve që duhen të ponderohen me rrezik sipas paragrafit 7 të këtij neni;

b) shuma e përcaktuar në nënpikën “i”, pjesëtuar me shumën e përcaktuar në nënpikën (ii):

i) shuma totale e instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë;

ii) shuma agregate e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të bankës në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të bankave dhe subjekteve të tjera financiare ku banka nuk ka investime të rëndësishme.

Neni 19

Zbritja e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar, ku banka ka investime të rëndësishme

1. Bankat zbresin nga kapitali bazë i nivelit të parë, shumën e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë të bankave dhe subjekteve të tjera financiare ku banka ka investime të rëndësishme.

2. Bankat përlogarisin pjesëmarrjet në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe instrumentet e tjera të bankave dhe subjekteve të tjera financiare në bazë të pozicioneve bruto në blerje.

3. Bankat, për qëllime të kësaj zbritjeje, do t'i trajtojnë zërat që i përkasin kapitalit bazë të shoqërive të sigurimit si pjesëmarrje në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë.

4. Bankat përlogarisin pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë të bankave dhe subjekteve të tjera financiare në bazë të pozicionit neto në blerje në të njëjtin ekspozim bazë, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) maturiteti i pozicionit në shitje përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose ka një maturitet të mbetur prej të paktën një viti;

³ “Pozicione nënshkrimi” janë pozicionet e nënshkrimit të titujve.



b) pozicionet në blerje dhe në shitje duhet të jenë kontabilizuar së bashku në librin e tregtueshëm ose së bashku në librin e bankës.

5. Bankat përcaktojnë shumën që do të zbritet në lidhje me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të letrave me vlerë të indekseve, duke përllogaritur ekspozimin bazë ndaj instrumenteve të kapitalit të bankave dhe subjekteve të tjera financiare në ato indekse:

a) bankat, për qëllime të kësaj zbritjeje, mund të përjashtojnë nga përllogaritja e shumës që do të zbritet, pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për pesë ditë pune ose më pak. Pozicionet e nënshkrimit, të mbajtura për më shumë se pesë ditë pune duhet të përfshihen në përllogaritje;

b) bankat mund të përjashtojnë përkohësisht disa investime kur këto janë bërë në kuadrin e zgjidhjes ose ofrimit të ndihmës financiare për të riorganizuar një institucion me probleme.

6. Investimet e përfshira në shkronjën “b” të paragrafit 5 të këtij neni, që janë në formën e aksioneve të zakonshme, do t’i nënshtrohen trajtimit kufi të specifikuar në nenin 20 të kësaj rregulloreje.

Neni 20

Përjashtimet kufi nga zbritjet nga zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë

1. Bankat, gjatë zbritjes së zërave të përcaktuar në nenin 11, paragrafi 1, shkronjat “c” dhe “h” të kësaj rregulloreje, nuk janë të detyruara të zbresin shumat e zërave të listuar në shkronjat “a dhe “b” të këtij paragrafi, të cilat në total janë të barabarta ose më të vogla se shuma kufi e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni:

a) aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme dhe në total janë të barabarta ose më të vogla se 10% e zërave të kapitalit bazë të nivelit të parë të bankës, të përllogaritur pas:

i) zbatimit të neneve 7 deri në 10 të kësaj rregulloreje;

ii) zbritjeve të përcaktuara në nenin 11 paragrafi 1, shkronjat “a” deri në “g”, shkronja “j” nën pikat (ii) dhe (iii), si dhe shkronjën “k”, duke përjashtuar shumën e zbritshme lidhur me aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme;

b) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të saj në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të këtyre subjekteve (të sektorit financiar), në rastet kur banka ka investime të rëndësishme në një subjekt të sektorit financiar, që janë në total të barabarta ose më pak se 10% e zërave të kapitalit bazë të nivelit të parë të bankës të përllogaritur pas:

i) zbatimit të neneve 7 deri në 10 të kësaj rregulloreje;

ii) zbritjeve të përcaktuara në nenin 11, paragrafi 1, shkronjat “a” deri në “g”, shkronja “j”, nën pikat (ii) dhe (iii), si dhe shkronjën “k”, duke përjashtuar shumën e zbritshme lidhur me aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme.

2. Për qëllime të paragrafit 1 të këtij neni, shuma kufi do të jetë e barabartë me shumën e përcaktuar në shkronjën “a” të këtij paragrafi, shumëzuar me përqindjen e përcaktuar në shkronjën “b” të këtij paragrafi:

a) vlera e mbetur e zërave të kapitalit bazë të nivelit të parë pas zbatimit të rregullimeve dhe zbritjeve të përcaktuara në nenin 7 deri në 11, plotësisht dhe pa zbatuar përjashtimet kufi të përcaktuara në këtë nen;

b) 17.65%.

3. Për qëllime të paragrafit 1, bankat do të përcaktojnë peshën e aktiveve të shtyra tatimore ndaj shumës totale të zërave që nuk kërkohet të zbritet, duke pjesëtuar shumën e përcaktuar në shkronjën “a” të këtij paragrafi me shumën e përcaktuar në shkronjën “b” të këtij paragrafi:

a) shuma e aktiveve tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme dhe në total janë të barabarta ose më pak se 10% e zërave të kapitalit bazë të nivelit të parë të bankës;

b) shuma e nënpikave të mëposhtme:

i) shuma e përcaktuar në shkronjën “a” të këtij paragrafi;

ii) shuma e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të bankës në instrumentet e kapitalit të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investime të rëndësishme dhe në total janë të barabarta me ose më pak se 10% e zërave të kapitalit bazë të nivelit të parë të bankës.



4. Bankat do të ponderojnë me 250% shumat e zërave që nuk zbriten në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

NËNKREU IV

KAPITALI SHITESË I NIVELIT TË PARË

Neni 21

Kapitali shtesë i nivelit të parë

1. Kapitali shtesë i nivelit të parë të bankës përbëhet nga elementet e mëposhtme:

- a) instrumentet e kapitalit që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 22, të kësaj rregulloreje; dhe
- b) primet e emetimit të lidhura me instrumentet e përcaktuara në shkronjën “a” të këtij paragrafi.

2. Instrumentet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni nuk mund të kualifikohen si kapital bazë i nivelit të parë dhe si kapital i nivelit të dytë.

3. Bankat mund të përfshijnë instrumentet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, në kapitalin shtesë të nivelit të parë, me kusht që ato (bankat) të marrin miratimin paraprak nga Banka e Shqipërisë.

4. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për përfshirjen e këtyre instrumenteve në kapitalin shtesë të nivelit të parë, vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 22 të kësaj rregulloreje.

5. Bankat, në zbatim të kushteve të përcaktuara në nenin 22 rregullores, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm si pjesë të kërkesës për marrjen e miratimit paraprak:

a) dokumentacioni bazë (kontratë, prospekt etj.) i lidhur me emetimin e këtyre instrumenteve;

b) një ilustrim skematik për plotësimin e tipareve/kushteve të kërkuara për të tilla instrumente, të përcaktuara në nenin 22 të kësaj rregulloreje, duke dhënë referencat përkatëse në dokumentacionin bazë sipas shkronjës “a” të këtij neni;

c) një përshkrim i trajtimeve kontabël të instrumenteve në fjalë, së bashku me një opinion nga një ekspert kontabël i autorizuar në lidhje me pranueshmërinë e tyre;

d) llogaritja e kapitalit rregullator dhe kërkesave për kapital në ditën e fundit të muajit, përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e miratimit paraprak;

e) një përlogaritje e kapitalit rregullator dhe kërkesave për kapital për periudhën e tre viteve të ardhshme.

Neni 22

Kushtet për njohjen e instrumenteve të kapitalit shtesë të nivelit të parë

1. Bankat përfshijnë instrumentet e kapitalit në kapitalin shtesë të nivelit të parë, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) të jenë të paguar;
- b) instrumentet nuk janë blerë nga asnjë prej subjekteve të mëposhtme:

- i) banka apo filiale të saj;
- ii) subjekte, në të cilat banka zotëron në mënyrë direkte ose me anë të kontrollit 20% ose më shumë të të drejtave të votës ose të kapitalit të tyre;

c) blerja e instrumenteve nuk është financuar direkt ose indirekt nga banka;

d) instrumentet renditen poshtë instrumenteve të përfshirë në kapitalin e nivelit të dytë në rast të situatave të paaftësisë paguese dhe likuidimit;

e) instrumentet nuk janë të siguruara ose të garantuara nga një prej subjekteve të mëposhtme, që përmirëson përparësinë e shlyerjes së pretendimeve ndaj kreditorëve të bankës:

- i) banka ose filialet e saj;
- ii) banka mëmë dhe filialet e tjera të saj;
- iii) shoqëria *holding* financiare mëmë ose filialet e saj;

iv) shoqëria *holding* me aktivitet të kombinuar ose filialet e saj;

v) shoqëria *holding* financiare me aktivitet të kombinuar ose filialet e saj;

vi) subjektet palë të lidhura me subjektet e përcaktuara në nënpikat më sipër (“i” deri në “v”);

f) instrumentet nuk janë subjekt i ndonjë marrëveshjeje apo kontrate që përmirëson përparësinë në këtë instrument, në situata të paaftësisë paguese ose të likuidimit;

g) instrumentet nuk kanë datë specifike maturiteti që burojnë nga ky instrument dhe instrumentet nuk përfshijnë incentiva për bankën për t’i shlyer ato;

h) kur instrumentet përfshijnë një ose më shumë opsione *call*, këto opsione mund të ushtrohen vetëm me diskrecion të emetuesit (bankës);



i) instrumentet mund të ripaguhet/shlyhen vetëm kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 38 të kësaj rregulloreje dhe jo më parë se pesë vite nga data e emetimit, përveç se kur plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 39 të kësaj rregulloreje (paragrafi 3);

j) instrumentet nuk specifikojnë në mënyrë direkte apo të tërthortë që ato mund të ekzekutohen/shlyhen ose riblihen, vetëm në rastet e:

i) likuidimit të saj (bankës);

ii) riblerjes së instrumenteve ose mënyrave të tjera të zvogëlimit të shumës së kapitalit shtesë të nivelit të parë, ku banka merr paraprakisht miratim nga Banka e Shqipërisë sipas kërkesave të përcaktuara të nenit 38;

k) Bankat nuk specifikojnë në mënyrë eksplicite apo implicite se Banka e Shqipërisë do të pranojë një kërkesë për tërheqje, shlyerje apo riblerje të instrumenteve;

l) pagesa e interesit (dividentit etj.), siç përcaktohet në kontratën e të tilla instrumenteve, përmbush kushtet e mëposhtme:

i) niveli i pagesës së interesit (dividentit) për këto instrumente nuk ndryshohet në bazë të cilësisë së kredisë së bankës apo të shoqërisë mëmë;

ii) dispozitat që rregullojnë këto instrumente i japin të drejtën bankës (*full discretion*) që, në çdo kohë, të anulojë shpërndarjen e interesave (dividentëve) për një periudhë kohe të pakufizuar dhe mbi baza jokumulative⁴, dhe banka mund t'i përdorë këto pagesa të anuluar pa kufizim për shlyerjen e detyrimeve të saj;

iii) anulimi i pagesave të interesit (dividentit etj.) nuk përbën ngjarje dështimi për bankën,

iv) anulimi i pagesave të interesit (dividentit) nuk vendos kufizime mbi bankën, vetëm me përjashtim të pagesave për aksionet e zakonshme;

m) dispozitat që rregullojnë këto instrumente përcaktojnë se, në rast të një ngjarjeje aktivizuese (*trigger event*), shumat e kryegjësë së instrumentit mund të ripaguhet/shlyhet (*written down*) në mënyrë të përkohshme apo të përhershme, ose instrumenti mund të konvertohet në instrumente

kapitali që përfshihen në kapitalin bazë të nivelit të parë (aksione të zakonshme);

n) dispozitat që rregullojnë këto instrumente nuk përmbajnë klauzola që pengojnë rikapitalizimin e bankës;

o) në rastet kur këto instrumente nuk emetohen direkt nga banka duhet të plotësojnë kushtet si më poshtë:

i) të jenë të emetuara nga një subjekt që përfshihet në mbikëqyrjen e konsoliduar të bankës;

ii) të ardhurat të jenë në dispozicion të menjëhershëm të bankës pa kufizime.

Neni 23

Kufizime në anulimin e pagesave të interesit dhe klauzolat që pengojnë rikapitalizimin e bankës

1. Dispozitat që rregullojnë instrumentet që përfshihen në kapitalin shtesë të nivelit të parë nuk duhet të përmbajnë:

a) detyrimin për pagesën e interesave (dividentëve etj.) në rast të kryerjes së pagesave për instrumentet e emetuara nga banka që kanë prioritet më të ulët ose të njëjtë me një instrument të përfshirë në kapitalin shtesë të nivelit të parë (*dividend pusher*);

b) detyrimin për ndalimin e pagesave të interesit për instrumentet e kapitalit të përfshira në kapitalin bazë ose shtesë të nivelit të parë dhe në kapitalin e nivelit të dytë, në rast se nuk janë kryer pagesat e interesave (dividentëve) për këto instrumente kapitali të përfshira në kapitalin e nivelit të parë shtesë (*dividend stopper*);

c) detyrimin për zëvendësimin e pagesës së interesit (dividentit) me një pagesë të një forme tjetër.

Neni 24

Kriteret për miratimin e ripagimit/shlyerjes ose konvertimit të instrumenteve të përfshira në kapitalin shtesë të nivelit të parë

1. Për qëllime të zbatimit të shkronjës “m” të nenit 22 të kësaj rregulloreje, zbatohen dispozitat e mëposhtme mbi instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë:

a) një ngjarje aktivizuese (*trigger event*), ndodh kur norma e kapitalit bazë të nivelit të parë të bankës bie nën një nga vlerat e mëposhtme:

i) 5,125 %;

⁴ Pagesat e interesit (dividentët etj.) nga këto instrumente të jenë jokumulative, që do të thotë se në rast se nuk janë paguar, ka humbur përfundimisht e drejta për të përfituar pagesën.



ii) në një nivel më të lartë se 5,125 %, kur përcaktohet nga banka dhe specifikohet në dispozitat që rregullojnë instrumentin;

b) bankat mund të përcaktojnë vetë ngjarje të tjera aktivizuese të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjën “a” të këtij neni;

c) kur dispozitat që rregullojnë instrumentin përcaktojnë konvertimin e tyre në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë, në rast të ndodhjes së një ngjarjeje aktivizuese, këto dispozita duhet të specifikojnë normën e konvertimit dhe një kufi të shumës që lejohet të konvertohet ose një interval brenda të cilit instrumentet do të konvertohen në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë;

d) kur dispozitat që rregullojnë instrumentin përcaktojnë zhvlerësimin e tyre në rast të ndodhjes së një ngjarjeje aktivizuese, zhvlerësimi duhet të reduktojë të gjitha elementet e mëposhtme:

i) detyrimin e mbajtësit të instrumentit, në rast paafësie paguese ose likuidimi të bankës;

ii) shumën që kërkohet të paguhet në rast ushtrimi të opsionit *call* ose shlyerjeje të instrumentit;

iii) pagesat e interesit (dividentit) të bëra mbi këtë instrument.

2. Ripagimi/shlyerja apo konvertimi i një instrumenti të kapitalit shtesë të nivelit të parë gjeneron elemente/zëra që kualifikohen si instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë.

3. Shuma e instrumenteve të kapitalit shtesë të nivelit të parë, të njohura në këtë lloj kapitali, kufizohet në minimumin e shumës së elementeve bazë të kapitalit të nivelit të parë që mund të gjenerohen në rast se suma e kryegjësë së instrumenteve të kapitalit të nivelit të parë shtesë do të zhvlerësohej plotësisht ose do të konvertohej në instrument të kapitalit të nivelit të parë bazë.

4. Shuma agregate e instrumenteve të kapitalit shtesë të nivelit të parë që është e detyrueshme të ripaguhet/shlyhet ose të konvertohet në rast të ndodhjes së ngjarjes aktivizuese, nuk duhet të jetë më e vogël se më e vogla ndërmjet:

a) shumës së nevojshme për të kthyer në nivelin prej 5,125% të normës së kapitalit bazë të nivelit të parë;

b) shumës së plotë të kryegjësë të instrumentit.

5. Bankat, në rast të ndodhjes së një ngjarjeje aktivizuese, kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë;

b) njofton mbajtësit e instrumenteve të kapitalit shtesë të nivelit të parë;

c) zhvlerëson kryegjënë e instrumenteve ose konverton pa vonesë instrumentet në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë, por jo më vonë se një muaj nga data e ndodhjes së ngjarjes.

6. Bankat, të cilat emetojnë instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë që konvertohen në kapital bazë të nivelit të parë, në rast të ndodhjes së një ngjarjeje aktivizuese, duhet të sigurojnë se kapitali aksionar (*authorised share capital*) të jetë në çdo kohë i mjaftueshëm, për të konvertuar të tilla instrumente në aksione.

7. Bankat sigurojnë në kohë të gjitha miratimet paraprake të nevojshme në datën e emetimit të aksioneve që përfshihen në kapitalin bazë të nivelit të parë, në të cilët do të konvertohen instrumentet që përfshihen në kapitalin shtesë të nivelit të parë, në rast të ndodhjes së një ngjarjeje aktivizuese.

8. Bankat, të cilat emetojnë instrumente që konvertohen në aksione që përfshihen në kapitalin e nivelit të parë bazë, në rast të ndodhjes së një ngjarjeje aktivizuese, duhet të sigurohen se nuk ka pengesa procedurale në statutin e tyre për konvertimin në fjalë.

Neni 25

Zbritjet nga kapitali shtesë i nivelit të parë

1. Bankat zbresin zërat e mëposhtëm nga kapitali shtesë i nivelit të parë:

a) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të vetë bankës në instrumentet e veta të përfshira në kapitalin e nivelit të parë shtesë, duke përfshirë edhe instrumentet në kapitalin e nivelit të parë shtesë që banka është e detyruar të blejë si rezultat i një detyrimi kontraktual;

b) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumente të kapitalit të nivelit të parë shtesë të institucioneve financiare me të cilët banka ka pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara), për të cilat Banka e Shqipërisë vlerëson se janë bërë me qëllim për të rritur në mënyrë artificiale kapitalin rregullator të bankës;

c) shumën e aplikueshme të përcaktuar në përputhje me nenin 29 për pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta apo sintetike në



instrumente të kapitalit të nivelit të parë shtesë të institucioneve financiare, ku banka nuk ka investime të rëndësishme në këto subjekte;

d) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumente të kapitalit të nivelit të parë shtesë të institucioneve financiare, ku banka ka investime të rëndësishme në këto subjekte, duke përjashtuar pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për pesë ditë ose më pak;

e) shumën e zërave të zbritshëm nga kapitali i nivelit të dytë, sipas nenit 33, që tejkalon kapitalin e nivelit të dytë të bankës;

f) çdo shpenzim për taksa (*tax charge*) që lidhen me elementet e kapitalit shtesë të nivelit të parë të parashikueshme në momentin e llogaritjes së tij, përveç rasteve kur banka rregullon në mënyrë të përshtatshme vlerat e zërave të kapitalit shtesë të nivelit të parë, për sa kohë të tilla shpenzime do zvogëlojnë vlerat deri në atë nivel, sa këto zëra mund të përdoren për të mbuluar rrezikun apo humbjet.

Neni 26

Zbritjet e pjesëmarrjeve në instrumentet e veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë

1. Bankat, për qëllime të nenit 25, shkronja “a”, llogarisin instrumentet e veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë në bazë të pozicioneve bruto në blerje (*long*), subjekt i përjashtimeve të mëposhtme:

a) bankat llogarisin shumën e pjesëmarrjes në instrumentet e vetë të kapitalit të nivelit të parë shtesë, në bazë të pozicionit neto në blerje, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) pozicionet në blerje dhe ato në shitje të jenë në të njëjtin ekspozim bazë (*underlying exposure*) dhe pozicionet në shitje të mos bartin rrezik kundërpattie;

ii) pozicionet në blerje dhe ato në shitje duhet të jenë kontabilizuar së bashku në librin e tregtueshëm ose së bashku në librin e bankës;

b) bankat përcaktojnë shumën që do të zbritet për pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta apo sintetike, në indekse të letrave me vlerë, duke llogaritur ekspozimet bazë në instrumentet e veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë në këto indekse;

c) bankat mund të netojnë pozicionet bruto në blerje në instrumentet e veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë, që rezultojnë nga zotërimet në indekse të letrave me vlerë me pozicionet në shitje në instrumentet e veta të kapitalit shtesë të nivelit të

parë që rezultojnë nga pozicionet në shitje në indekset bazë, duke përfshirë ato pozicione që kanë rrezik kundërpattie, me kushtin që të plotësohen kriteret e mëposhtme:

i) pozicionet në blerje dhe në shitje të jenë të të njëjtit indeks bazë;

ii) pozicionet në blerje dhe ato në shitje të jenë kontabilizuar së bashku në librin e tregtueshëm ose së bashku në librin e bankës.

Neni 27

Zbritja e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë të institucioneve financiare, ku banka ka pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) të krijuara për të rritur artificialisht kapitalin

1. Bankat zbresin nga kapitali shtesë i nivelit të parë pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë të bankave dhe subjekteve të tjera financiare kur këto subjekte kanë pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) me bankën, të cilat Banka e Shqipërisë vlerëson se janë krijuar për të rritur artificialisht kapitalin e bankës.

2. Bankat zbresin pjesëmarrjet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) pjesëmarrjet në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe instrumentet e tjera të bankave dhe subjekteve të tjera financiare do të përlllogariten në bazë të pozicioneve bruto në blerje;

b) për qëllime të kësaj zbritjeje, zërat që i përkasin kapitalit bazë të shoqërive të sigurimit do të trajtohen si pjesëmarrje në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë.

Neni 28

Zbritjet e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar

1. Bankat bëjnë zbritjet e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “d” të nenit 25, si më poshtë:

a) bankat llogarisin shumën e pjesëmarrjes në instrumentet e veta të kapitalit të nivelit të parë shtesë në bazë të pozicionit neto në blerje, në të njëjtin ekspozim bazë nëse plotësohen kriteret e mëposhtme:

i) maturiteti i pozicionit në shitje përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose pozicioni në



shitje është me maturitet të mbetur të paktën një vit;

ii) pozicionet në blerje dhe ato në shitje duhet të jenë kontabilizuar së bashku në librin e tregtueshëm ose së bashku në librin e bankës.

Neni 29

Zbritjet e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë, ku banka nuk ka investime të rëndësishme në subjekte të sektorit financiar

1. Bankat, për qëllime të shkronjës “c” të nenit 25, llogarisin shumën e aplikueshme për t'u zbritur duke shumëzuar shumën e referuar në shkronjën “a” të këtij paragrafi, me faktorin që rrjedh nga llogaritjet e referuara në shkronjën “b” të këtij paragrafi:

a) shumën agregate të pjesëmarrjeve e drejtpërdrejta, të tërthorta apo sintetike në instrumente të kapitalit bazë dhe shtesë të nivelit të parë dhe në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të institucioneve financiare, e cila tejkalon 10% të kapitalit të nivelit të parë bazë të bankës, pas:

i) zbatimit të neneve 7 deri në 10;

ii) zbritjeve të përcaktuara në nenin 11 paragrafi 1, shkronjat “a” deri në “f”, shkronja “j”, nënpiakat (ii) dhe (iii), dhe shkronjën “k”, duke përjashtuar shumën e zbritshme lidhur me aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme;

b) raportin e shumës së pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta apo sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të parë shtesë në institucione financiare ku banka nuk ka investime të rëndësishme me shumën agregate të pjesëmarrjeve/zotërimeve e drejtpërdrejta, të tërthorta apo sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të parë bazë dhe shtesë dhe në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë në të tilla institucione financiare.

2. Bankat përjashtojnë pozicionet në nënshkrime të mbajtura 5 ose më pak ditë pune nga shuma e referuar në paragrafin 1, shkronja “a”, dhe nga llogaritjet e bëra në paragrafin 1, shkronja “b”, të këtij neni.

3. Shuma që do të zbritet sipas paragrafit 1 të këtij neni do të jetë proporcionale për të gjithë instrumentet e kapitalit të nivelit të parë shtesë. Shuma që do të zbritet nga çdo instrument që përfshihet në kapitalin e nivelit të parë shtesë do të llogaritet duke shumëzuar shumën e specifikuar në

shkronjën “a” të këtij paragrafi, me shifrën e përcaktuar sipas shkronjës “b” të po këtij paragrafi:

a) shuma e pjesëmarrjeve që duhet të zbritet sipas paragrafit 1 të këtij neni;

b) shuma e specifikuar në pikën “i”, pjesëtuar me shumën e specifikuar në pikën “ii”:

i) shuma totale e instrumentit të kapitalit të nivelit të parë shtesë;

ii) shuma agregate e pjesëmarrjeve/të drejtpërdrejta, të tërthorta apo sintetike në instrumente të kapitalit të nivelit të parë shtesë në institucione financiare ku banka nuk ka investime të rëndësishme.

4. Shumat e pjesëmarrjeve të përcaktuara në shkronjën “c” të nenit 25, të cilat janë më të vogla ose të barabarta me 10% të kapitalit të nivelit të parë bazë, pasi janë aplikuar nënpiakat “i” dhe “ii” të shkronjës “a” të paragrafit të parë të këtij neni, nuk do të zbriten nga kapitali rregulator, por do të ponderohen me peshat e rrezikut sipas kapitullit të rrezikut të kredisë, të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

5. Bankat përcaktojnë pjesën e pjesëmarrjeve në instrumente kapitali që ponderohen me rrezik, duke shumëzuar shumën e specifikuar në pikën “a” me shumën e specifikuar në pikën “b”, si më poshtë:

a) shuma e pjesëmarrjeve/zotërimeve që duhet të ponderohet me rrezik sipas paragrafit 4 të këtij neni;

b) përqindja që rezulton nga përlllogaritja në shkronjën “b” të paragrafit 3.

KREU III

KAPITALI I NIVELIT TË DYTË

Neni 30

Struktura dhe elementet përbërëse

1. Kapitali i nivelit të dytë përbëhet nga elementet e mëposhtme:

a) instrumentet e kapitalit dhe borxhi i varur që plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në kapitalin e nivelit të dytë (dhe që nuk janë përfshirë në kapitalin e nivelit të parë);

b) primet e emetimit të lidhura me instrumentet e përcaktuara në shkronjën “a” të këtij paragrafi.

2. Elementet e përfshira në shkronjën “a”, të paragrafit 1, të këtij neni nuk kualifikohen si elemente të kapital bazë të nivelit të parë ose si elemente të kapitalit shtesë të nivelit të parë.



3. Bankat mund të përfshijnë elementet e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, në kapitalin e nivelit të dytë, vetëm me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.

4. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për përfshirjen e instrumenteve të kapitalit dhe instrumentet e borxhit të varur në kapitalin e nivelit të dytë, vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 31 të kësaj rregulloreje.

5. Bankat në zbatim të kushteve të përcaktuara në nenin 31 të rregullores, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm si pjesë të kërkesës për marrjen e miratimit paraprak:

a) dokumentacioni bazë (kontratë, prospekt etj.) i lidhur me emetimin e këtyre instrumenteve;

b) një ilustrim skematik të plotësimit të tipareve/kushteve të kërkuara për të tilla instrumente, të përcaktuara në nenin 31 të kësaj rregulloreje, duke dhënë referencat përkatëse në dokumentacionin bazë sipas shkronjës “a” të këtij neni;

c) një përshkrim i trajtimeve kontabël të instrumenteve në fjalë, së bashku me një opinion nga një ekspert kontabël i autorizuar, në lidhje me pranueshmërinë e tyre;

d) llogaritja e kapitalit rregullator dhe kërkesave për kapital në ditën e fundit të muajit, përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e miratimit paraprak;

e) një përlogaritje e kapitalit rregullator dhe kërkesave për kapital për periudhën e tre viteve të ardhshme.

Neni 31

Kushtet për njohjen e instrumenteve të kapitalit dhe të borxhit të varur të kapitalit të nivelit të dytë

1. Bankat kualifikojnë si instrumente të kapitalit të nivelit të dytë instrumentet e kapitalit dhe borxhin e varur, pavarësisht nga forma juridike ose trajtimi kontabël i tyre, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) instrumentet ose borxhi i varur të jenë emetuar nga banka dhe të jenë plotësisht të paguar;

b) instrumentet të mos jenë blerë ose borxhi i varur të mos jetë financuar nga asnjë prej subjekteve të mëposhtme:

i) banka apo filiale të saj;

ii) subjekte, në të cilat banka zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të kontrollit 20 % ose

më shumë të të drejtave të votës ose të kapitalit të tyre;

c) blerja e instrumenteve ose financimi i borxhit të varur nuk është kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga banka;

d) sipas dispozitave të kontratës së instrumenteve ose të borxhit të varur, në çdo rast, pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë kanë përparësi shlyerje më të lartë krahasuar me pretendimin mbi kryegjënë e instrumenteve ose pretendimin e borxhit të varur;

e) instrumentet ose borxhi i varur nuk janë të garantuara dhe nuk janë subjekt i një garancie që përmirëson prioritetin e pretendimeve nga një prej subjekteve të mëposhtme:

i) banka ose filialet e saj;

ii) banka mëmë dhe filialet e tjera të saj;

iii) shoqëria *holding* financiare mëmë ose filialet e saj;

iv) shoqëria *holding* me aktivitet të kombinuar ose filialet e saj;

v) shoqëria *holding* financiare me aktivitet të kombinuar ose filialet e saj;

vi) subjektet palë të lidhura me subjektet e përcaktuara në nënpikat më sipër (“i” deri në “v”);

f) instrumentet ose borxhi i varur nuk janë subjekt i ndonjë marrëveshjeje që në rastin e kundërt përmirëson përparësinë respektivisht për instrumentet ose borxhin e varur;

g) instrumentet ose borxhi i varur kanë një maturitet fillestar të paktën 5 (pesë)-vjeçar;

h) kur dispozitat e kontratës së instrumenteve ose borxhit të varur nuk përfshijnë asnjë nxitje (incentivë) për të shlyer apo riblerë shumën e tyre të kryegjësë nga banka, para afatit të maturimit;

i) kur instrumentet ose borxhi i varur përfshijnë një ose më shumë opsione *call* ose opsione të ripagesës së hershme, këto opsione mund të ushtrohen vetëm me diskrecion të emetuesit (bankës);

j) instrumentet ose borxhi i varur mund të ripaguhën/shlyhen vetëm kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 37 dhe jo më parë se pesë vite nga data e emetimit ose e financimit, përveç se kur plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 39, paragrafi 3;

k) dispozitat e kontratës së instrumenteve ose borxhit të varur nuk specifikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që këto instrumente ose borxhi i varur mund të ekzekutohen/shlyhen

ose riblihen nga banka vetëm në rastet e paaftësisë paguese apo likuidimit të bankës;

l) dispozitat e kontratës së instrumenteve ose borxhit të varur nuk i japin të drejtën zotëruesit të përshpejtojë planin e pagesave të interesave dhe të kryegjësë në të ardhmen, përveç rasteve të paaftësisë paguese apo likuidimit të bankës;

m) niveli i pagesës së interesit ose dividendit për këto instrumente ose borxhin e varur, nuk ndryshohet në bazë të cilësisë së bankës apo të bankës mëmë;

n) në rastet kur këto instrumente ose borxhi i varur nuk janë emetuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga banka, duhet të plotësojnë njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

i) të jenë të emetuara nga një subjekt që përfshihet në mbikëqyrjen e konsoliduar të bankës,

ii) të ardhurat (fitimet) janë në dispozicion të menjëhershëm të bankës, pa kufizime.

Neni 32

Kriteret për miratimin e ripagimit/shlyerjes ose konvertimit të instrumenteve të kapitalit të nivelit të dytë

1. Bankat llogarisin shumën në të cilën instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë kualifikohen/përfshihen si zëra të kapitali të nivelit të dytë, gjatë pesë viteve të fundit të maturimit të instrumenteve, duke shumëzuar rezultatin e përfutur nga përllogaritja në shkronjën “a” të këtij paragrafi me shumën në shkronjën “b”, si më poshtë:

a) shuma nominale e instrumenteve ose e borxhit të varur, në ditën e parë të periudhës së fundit pesëvjeçare të maturitetit kontraktual, pjesëtuar me numrin e ditëve kalendarike në atë periudhë;

b) numri i ditëve të mbetura kalendarike të maturitetit kontraktual të instrumenteve ose borxhit të varur.

Neni 33

Zbritjet nga kapitali i nivelit të dytë

1. Bankat zbresin nga kapitali i nivelit të dytë zërat e mëposhtëm:

a) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të vetë bankës, në instrumentet e veta të përfshira në kapitalin e nivelit të dytë, duke përfshirë edhe instrumentet e veta të kapitalit të nivelit të dytë që banka është e detyruar t'i blejë, si rezultat i një detyrimi kontraktual;

b) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të institucioneve financiare në të cilët banka ka pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara), për të cilat Banka e Shqipërisë vlerëson se janë krijuar me qëllim për të rritur në mënyrë artificiale kapitalin rregullator të bankës;

c) shumën e aplikueshme, të përcaktuar në përputhje me nenin 37 për pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të institucioneve financiare, ku banka nuk ka investime të rëndësishme në këto subjekte;

d) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të institucioneve financiare, ku banka ka investime të rëndësishme në këto subjekte, duke përjashtuar pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për më pak se pesë ditë pune.

2. Bankat zbresin nga kapitali i nivelit të dytë edhe shumën e investimeve të saj (bankës) në ndërtesa dhe në mjete të tjera të qëndrueshme të trupëzuara që tejkalon 25% të kapitalit rregullator.

Neni 34

Zbritjet e pjesëmarrjeve në instrumentet e veta të kapitalit të nivelit të dytë

1. Bankat, për qëllime të shkronjës “a”, paragrafi 1, të nenit 33 të kësaj rregulloreje, llogarisin pjesëmarrjet në bazë të pozicioneve bruto në blerje (*long*), subjekt i përjashtimeve të mëposhtme:

a) bankat llogarisin shumën e pjesëmarrjes në bazë të pozicionit neto në blerje, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) pozicionet në blerje dhe në shitje të jenë në të njëjtin ekspozim bazë (*underlying exposure*) dhe pozicionet në shitje nuk bartin rrezik kundërpattie;

ii) pozicionet në blerje dhe ato në shitje duhet të jenë kontabilizuar së bashku në librin e tregtueshëm ose së bashku në librin e bankës;

b) bankat përcaktojnë shumën që do të zbritet për pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në indekse të letrave me vlerë, duke llogaritur ekspozimet bazë në instrumentet e veta të kapitalit të nivelit të dytë në këto indekse;

c) bankat mund të netojnë pozicionet bruto në blerje në instrumentet e veta të kapitalit të nivelit të dytë, që rezultojnë nga zotërimet në indekse të letrave me vlerë me pozicionet në shitje në



instrumentet e veta të kapitalit të nivelit të dytë që rezultojnë nga pozicionet në shitje në indekset bazë, duke përfshirë ato pozicione që kanë rrezik kudërpartie, me kushtin që të plotësohen të dyja kriteret e mëposhtme:

i) pozicionet në blerje dhe në shitje janë të të njëjtit indeks bazë;

ii) pozicionet në blerje dhe ato në shitje duhet të jenë kontabilizuar së bashku në librin e tregtueshëm ose së bashku në librin e bankës.

Neni 35

Zbritja e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë të institucioneve financiare, ku banka ka pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) të krijuara për të rritur artificialisht kapitalin

1. Bankat zbresin nga kapitali shtesë i nivelit të dytë pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë të bankave dhe subjekteve të tjera financiare kur këto subjekte kanë pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) me bankën, të cilat Banka e Shqipërisë vlerëson se janë krijuar për të rritur artificialisht kapitalin e bankës.

2. Bankat zbresin pjesëmarrjet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) pjesëmarrjet në instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë dhe instrumentet e tjera të bankave dhe subjekteve të tjera financiare do të përllogariten në bazë të pozicioneve bruto në blerje;

b) për qëllime të kësaj zbritjeje, zërat që i përkasin kapitalit shtesë të shoqërive të sigurimit do të trajtohen si pjesëmarrje në instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë.

Neni 36

Zbritjet e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë të subjekteve të sektorit financiar

Bankat bëjnë zbritjet e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “d” të nenit 33, si më poshtë:

a) mund të përllogarisin pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të instrumenteve të kapitalit të nivelit të dytë të subjekteve të sektorit financiar në bazë të pozicionit neto në blerje, në të njëjtin ekspozim bazë, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) maturiteti i pozicionit në shitje përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose pozicioni në shitje është me maturitet të mbetur të paktën 1 vit;

ii) të dy pozicionet janë të mbajtura në librin e bankës ose të dyja janë të mbajtura në librin e tregtueshëm;

b) përcaktojnë shumën që do të zbritet për pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në indekse të letrave me vlerë, duke llogaritur ekspozimet bazë në instrumentet e kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në këto indekse.

Neni 37

Zbritjet e pjesëmarrjeve në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë, ku banka nuk ka investime të rëndësishme në një subjekt të sektorit financiar

1. Bankat, për qëllime të shkronjës “c” të nenin 33 të kësaj rregulloreje, do të llogarisin shumën e aplikueshme për t’u zbritur, duke shumëzuar shumën e referuar në shkronjën “a” të këtij paragrafi me faktorin që rrjedh nga llogaritjet e referuara në shkronjën “b” të këtij paragrafi:

a) shumën agregate të pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të parë bazë dhe shtesë dhe në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të subjekteve të sektorit financiar, ku banka nuk ka investime të rëndësishme që tejkalon 10% të kapitalit të nivelit të parë bazë të bankës, i llogaritur pas:

i) zbatimit të neneve 7 deri në 10;

ii) zbritjeve të përcaktuara në nenin 11, paragrafi 1, shkronjat “a” deri në “f”, shkronja “j”, nënparagrafi (ii) dhe (iii), dhe shkronja “k”, duke përjashtuar shumën e zbritshme lidhur me aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme;

b) raportin e shumës së pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të subjekteve të sektorit financiar ku banka nuk ka investime të rëndësishme, me shumën agregate të të gjitha pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumente të kapitalit të nivelit të parë bazë dhe shtesë dhe në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë në të tilla institucione financiare.

2. Bankat përjashtojnë pozicionet e nënshkruara (*underwriting*) të mbajtura 5 ose më pak ditë pune,



nga shuma e referuar në paragrafin 1, shkronja “a”, dhe nga llogaritjet e bëra në paragrafin 1, shkronja “b”.

3. Shuma që do të zbritet sipas paragrafit 1 të këtij neni do të jetë proporcionale për të gjitha instrumentet e kapitalit të nivelit dytë. Shuma që do të zbritet nga çdo instrument që përfshihet në kapitalin e nivelit të dytë, do të llogaritet duke shumëzuar shumën e specifikuar në shkronjën “a” të këtij paragrafi, me shifrën e përcaktuar sipas shkronjës “b” të po këtij paragrafi:

a) shuma e pjesëmarrjeve që duhet të zbritet sipas paragrafit 1 të këtij neni;

b) përqindja e shumës agregate të pjesëmarrjeve/zotërimeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë, të subjekteve të sektorit financiar ku banka nuk ka një investim të rëndësishëm, që përfaqësohet nga çdo instrument i mbajtur i kapitali të nivelit të dytë.

4. Shumat e pjesëmarrjeve të përcaktuara në shkronjën “c” të nenit 33, të cilat janë më të vogla ose të barabarta me 10% të kapitalit të nivelit të parë bazë, pasi janë aplikuar dispozitat në shkronjën “a” nën-pika “i” dhe shkronja “a” nën-pika “ii” e paragrafit 1 të këtij neni, nuk do të zbriten nga kapitali rregullator, por do të ponderohen me peshat e rrezikut sipas kapitullit të rrezikut të kredisë, të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

5. Bankat përcaktojnë pjesën e pjesëmarrjeve të çdo instrumenti të kapitalit të nivelit të dytë, që ponderohet me rrezik, sipas paragrafit 4 të këtij neni, duke shumëzuar shumën e specifikuar në shkronjën “a”, me shumën e specifikuar në shkronjën “b” të këtij paragrafi, si më poshtë:

a) shuma e pjesëmarrjeve që duhet të ponderohet me rrezik sipas paragrafit 4 të këtij neni;

b) përqindja që rezulton nga përlllogaritja në shkronjën “b” të paragrafit 3 të këtij neni.

KREU IV

KËRKESA MBIKËQYRËSE DHE MONITORUESE

Neni 38

Kushtet për zvogëlimin e kapitalit rregullator

1. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për të kryer secilin apo së bashku veprimet e mëposhtme:

Faqe | 12794

a) të zvogëlojë, të ripaguajë/të shlyejë instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të emetuara nga banka në zbatim të akteve rregullative të brendshme të bankës, si dhe të kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi;

b) të ripaguajë/të shlyejë instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë ose instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë, para datës së maturimit kontraktual.

Neni 39

Miratimi paraprak për zvogëlimin e kapitalit rregullator

1. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për të zvogëluar, për të riblerë ose për të shlyer kapitalin e nivelit të parë bazë, instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë ose të nivelit të dytë, nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

a) bankat i zëvendësojnë në të njëjtën kohë ose më herët instrumentet e cituara në nenin 38, me instrumente të kapitalit rregullator me një cilësi të njëjtë ose më të lartë, me kusht që këto instrumente të jenë të qëndrueshëm për kapacitetin e të ardhurave të bankës;

b) bankat duhet të vërtetojnë se pas kryerjes së këtij veprimi kapitali rregullator nuk do të bjerë nën kufijtë e treguesve të përcaktuar në nenin 42 të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë, gjatë procesit të vlerësimit të qëndrueshmërisë së instrumenteve që do të zëvendësohen për kapacitetin e të ardhurave të bankës, duhet të marrë në konsideratë shkallën/masën në të cilën këto instrumente të reja të kapitalit do të jenë më të kushtueshme për bankën se sa ato që do të zëvendësojë.

3. Banka e Shqipërisë mund t'i japë miratimin paraprak bankës për të shlyer instrumentet e kapitalit të nivelit të parë dhe të dytë, përpara pesë viteve nga data e emetimit të tyre, vetëm kur janë plotësuar kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe janë plotësuar kushtet e përcaktuara në shkronjat “a” ose “b” të këtij paragrafi:

a) ka një ndryshim në klasifikimin rregullator të këtyre instrumenteve që mund të rezultojë me përjashtimin e tyre nga kapitali rregullator ose duke i riklasifikuar me një cilësi më të ulët, si dhe plotësohen njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

i) Banka e Shqipërisë vlerëson që një ndryshim i tillë është mjaft i sigurt;



ii) bankat vërtetojnë se riklasifikimi rregullator i këtyre instrumenteve nuk ishte i parashikuar (në mënyrë të arsyeshme) në kohën e emetimit të tyre;

b) ka një ndryshim në trajtimin tatimor të këtyre instrumenteve për të cilat banka vërteton se ky ndryshim është material dhe nuk ishte i parashikuar (në mënyrë të arsyeshme) në kohën e emetimit të tyre.

Neni 40

Heqja dorë/përrjashtimi përkohësisht nga zvogëlimi i kapitalit rregullator

1. Banka e Shqipërisë, në rastet kur banka zotëron instrumente kapitali ose ka emetuar përkohësisht borxh të varur në një subjekt të sektorit financiar, të cilat klasifikohen si kapital bazë i nivelit të parë ose instrumente të kapitalit të nivelit të parë ose të dytë, si dhe nëse Banka e Shqipërisë gjykon se këto zotërime kanë për qëllim një transaksion në formën e ndihmës financiare për riorganizimin juridik apo zgjidhjen e saj (shoqërisë), mund të përrjashtojë bankën përkohësisht nga aplikimi i dispozitave të zbatueshme për zbritjet e këtyre instrumenteve.

Neni 41

Rishikimi i vazhdueshëm i cilësisë së kapitalit rregullator

1. Banka e Shqipërisë monitoron në vazhdimësi cilësinë e instrumenteve të emetuara të kapitalit rregullator dhe, në çdo rast, nëse evidenton rënie të cilësisë së këtyre instrumenteve, mund t'i kërkojë bankës emetimin e instrumenteve të reja më cilësore.

Neni 42

Kufijtë e treguesve të kapitalit rregullator

1. Bankat respektojnë në çdo kohë nivelin e treguesve të mëposhtëm të kapitalit:

a) 4.5% të kapitalit bazë të nivelit të parë ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun;

b) 6% të kapitalit të nivelit të parë ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun;

c) 12% të kapitalit rregullator ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun.

Neni 43

Kërkesat raportuese

1. Bankat paraqesin në fund të çdo muaji në Bankën e Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes, kapitalin rregullator të llogaritur sipas formularëve të përcaktuar në aneksin 1, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 44

Masat mbikëqyrëse

1. Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat.

Neni 45

Dispozita përfundimtare

1. Aneksi 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje është pjesë përbërëse e saj.

ZËVENDËSKRYETARI

Elisabeta Gjoni



KAPITALI RREGULLATOR			
Nr.	Zëri	Shuma	Udhëzues
1	KAPITALI RREGULLATOR	1.1 + 1.2	Neni 5: Kapitali rregullator llogaritet si shumë e kapitalit të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë
1.1	KAPITAL I NIVELIT TË PARË	1.1.1 + 1.1.2	Neni 6: Kapitali i nivelit të parë llogaritet si shumë e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit shtesë të nivelit të parë
1.1.1	KAPITAL BAZË I NIVELIT TË PARË	1.1.1.1 + 1.1.1.2 + 1.1.1.3 + 1.1.1.4 + 1.1.1.5 + 1.1.1.6 + 1.1.1.7 + 1.1.1.8 + 1.1.1.9 + 1.1.1.10 + 1.1.1.11 + 1.1.1.12 + 1.1.1.13 + 1.1.1.14 + 1.1.1.15 + 1.1.1.16 + 1.1.1.17 + 1.1.1.18	Neni 6
1.1.1.1	Instrumente të kapitalit të njohura si kapital bazë i nivelit të parë (KBN1)	1.1.1.1.1 + 1.1.1.1.3 + 1.1.1.1.4 + 1.1.1.1.5	Neni 6, neni 11 dhe neni 16.
1.1.1.1.1	Kapitali i paguar		Neni 6, paragrafi 2, shkronja “a”, neni 11. Shuma që do raportohet nuk do të përfshijë primet e emetimit të lidhura me instrumentet.
1.1.1.1.2	Zëra memorandumi: Instrumente kapitali jo të njohura		
1.1.1.1.3	Primet e aksioneve		Neni 6. Shuma që do të raportohet do të jetë pjesë e lidhur me kapitalin e paguar.
1.1.1.1.4	(-) Instrumente të veta të kapitalit bazë të nivelit të parë	1.1.1.1.4.1 + 1.1.1.1.4.2 + 1.1.1.1.4.3	Neni 11, shkronja “e”, neni 16. Shuma që do raportohet do të përfshijë primet e aksioneve që lidhen me aksionet e veta.
1.1.1.1.4.1	(-) Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë		Neni 11, shkronja “e”, neni 16.
1.1.1.1.4.2	(-) Pjesëmarrje të tërthorta në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë		Neni 11, shkronja “e”, neni 16.
1.1.1.1.4.3	(-) Pjesëmarrje sintetike në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë		Neni 11, shkronja “e”, neni 16.
1.1.1.1.5	(-) Detyrime aktuale ose të mundshme për të blerë instrumente të veta të kapitalit bazë të nivelit të parë		Neni 11, shkronja “e”, neni 16.
1.1.1.2	Fitimet e pashpërndara	1.1.1.2.1 + 1.1.1.2.2 + 1.1.1.2.3	Neni 6, paragrafi 2, shkronja “e”, neni 6 paragrafi 8.
1.1.1.2.1	Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme		Neni 6 paragrafi 2, shkronja “e”.
1.1.1.2.2	Fitimi ushtrimor i fundit të vitit		Neni 6, paragrafi 2, shkronja “d”.
1.1.1.2.3	Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese		Neni 6, paragrafi 2, shkronja “e”, neni 11 paragrafi 1, shkronja “a”
1.1.1.3	Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)		Neni 6, paragrafi 2, shkronja “f”
1.1.1.4	Diferenca rivlerësimi kreditorë		Neni 6, paragrafi 2, shkronja “g”
1.1.1.5	Rregullime të KBN1 lidhur me filtrat prudencialë	1.1.1.5.1 + 1.1.1.5.2 + 1.1.1.5.3 + 1.1.1.5.4 + 1.1.1.5.5	Nenet 7-10
1.1.1.5.1	(-) Rritjet në kapital që burojnë nga aktivet e titullzuara		Neni 7: Shuma që do të raportohet është rritja në vlerën e kapitalit të bankës që rezulton nga aktivet e titullzuara në përputhje me standardet kontabël. Për shembull, ky zë përfshin të ardhurat e ardhshme nga marzhi që rezultojnë nga një fitim nga shitja për bankën, ose për origjinuesin fitimet neto që burojnë nga kapitalizimi i të ardhurave të ardhshme nga aktivet e titullzuara që mundësojnë përmirësim të cilësive së kredisë për pozicionet në titullzim.
1.1.1.5.2	Rezerva e mbrojtjes nëpërmjet flukseve të parasë		Neni 8, paragrafi 1, shkronja “a”: Shuma që do të raportohet mund të jetë pozitive ose negative. Do të jetë pozitive nëse mbrojtjet nëpërmjet flukseve të parasë rezultojnë në humbje (duke reduktuar kështu kapitalin) dhe anasjelltas. Pra shenja e raportuar do të jetë e kundërta e asaj që përdoret në pasqyrat kontabël. Shuma do të jetë neto nga cdo tatim i parashikueshëm në momentin e përlogaritjes.
1.1.1.5.3	Fitimet dhe humbjet e përcaktuara që burojnë nga detyrimet e matura me vlerën e drejtë, si rezultat i ndryshimeve në rrezikun e kredisë të vetë bankës		Neni 8, paragrafi 1, shkronja “b”: Fitimet ose humbjet nga detyrimet e bankës që vlerësohen me vlerë të drejtë, që rezultojnë nga ndryshimet në vlerësimin e kredisë (credit rating) të vetë bankës.



			Shuma që do të raportohet mund të jetë pozitive ose negative. Do të jetë pozitive nëse ka humbje si rezultat i ndryshimeve në rrezikun e vet të kredisë (duke reduktuar kështu kapitalin) dhe anasjellas. Pra, shenja e raportuar do të jetë e kundërta e asaj që përdoret në pasqyrat kontabël. Fitimet e paauditua nuk do të përfshihen në këtë zë.
1.1.1.5.4	Fitime dhe humbje me vlerën e drejtë që burojnë nga rreziku i kredisë së vetë institucionit lidhur me detyrimet derivative		Neni 8, paragrafi 1, shkronja “c” dhe paragrafi 2: c. Fitimet ose humbjet e vlerës së drejtë që burojnë nga rreziku i kredisë së vetë bankës lidhur me detyrimet derivative. Shuma që do të raportohet mund të jetë pozitive ose negative. Do të jetë pozitive nëse ka humbje si rezultat i ndryshimeve në rrezikun e vet të kredisë dhe anasjellas. Pra, shenja e raportuar do të jetë e kundërta e asaj që përdoret në pasqyrat kontabël. Fitimet e paauditua nuk do të përfshihen në këtë zë.
1.1.1.5.5	(-) Rregullime të vlerës sipas kërkesave për vlerësimin prudent		Neni 9: Në përputhje me nenin 142 “Kërkesa për vlerësimin e zërave të librit të tregtueshëm” të rregullores për mjaftueshmërinë e kapitalit, për të gjitha aktivet e matura me vlerën e drejtë gjatë përllogaritjes së kapitalit rregullator, dhe zbresin nga kapitali bazë i nivelit të parë shumën e çdo rregullimi vlere shtesë që mund të jetë i nevojshëm.
1.1.1.6	(-) Emri i mirë	1.1.1.6.1 + 1.1.1.6.2 + 1.1.1.6.3	Neni 11, paragrafi 1, shkronja “b” dhe neni 12
1.1.1.6.1	(-) Emri i mirë i klasifikuar si aktiv i patrupëzuar		Neni 11, paragrafi 1, shkronja “b”: Emri i mirë këtu do të ketë të njëjtin kuptim me përkufizimin sipas standardeve kontabël. Shuma që do të raportohet do të jetë e njëjtë me atë të paraqitur në bilanc.
1.1.1.6.2	(-) Emri i mirë i përfshirë në vlerësimin e investimeve të rëndësishme		Neni 12, paragrafi 2, shkronja “b”
1.1.1.6.3	Detyrimet tatimore të shtyra të lidhura me emrin e mirë		Neni 12, paragrafi 2, pika “a”: Shuma e detyrimeve tatimore të shtyra që do të fshiheshin nëse emri i mirë do të zhvlerësohej ose fshihej sipas standardeve kontabël.
1.1.1.7	(-) Aktive të tjera të patrupëzuara	1.1.1.7.1 + 1.1.1.7.2	Neni 11, paragrafi 1, shkronja “b”, dhe neni 12, paragrafi 2, pika “a”: Aktivet e tjera të patrupëzuara janë aktivet e patrupëzuara sipas standardeve kontabël, minus emrin e mirë, po sipas standardeve kontabël.
1.1.1.7.1	(-) Shuma bruto e aktiveve të tjera të patrupëzuara		Neni 11, paragrafi 1, shkronja “b”: Aktivet e tjera të patrupëzuara janë aktivet e patrupëzuara sipas standardeve kontabël, minus emrin e mirë, po sipas standardeve kontabël. Shuma që duhet të raportohet këtu do të korrespondojë me shumën e raportuar në bilanc të aktiveve të patrupëzuara të ndryshme nga emri i mirë.
1.1.1.7.2	Detyrimet tatimore të shtyra të lidhura me aktivet e tjera të patrupëzuara		Neni 12, paragrafi 2, pika “a”: Shuma e detyrimeve tatimore të shtyra që do të fshihej nëse aktivet e patrupëzuara të ndryshme nga emri i mirë do të zhvlerësoheshin ose fshiheshin sipas standardeve kontabël.
1.1.1.8	(-) Aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe nuk burojnë nga diferencat e përkohshme, të netuara me detyrimet tatimore të lidhura		Neni 11, paragrafi 1, shkronja “c” dhe neni 13
1.1.1.9	(-) Aktivet e fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar	1.1.1.9.1 + 1.1.1.9.2 + 1.1.1.9.3	Neni 11, paragrafi 1, shkronja “d”, dhe neni 15
1.1.1.9.1	(-) Shuma bruto e aktiveve të fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar		Neni 11, paragrafi 1, shkronja “d”: Aktivet e fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar përkufizohen si ‘aktivet e një fondi ose plani pensionesh me përfitim të përcaktuar, të përllogaritura pasi janë zvogëluar me shumën e detyrimeve nën të njëjtin fond ose plan’. Shuma që do të raportohet këtu do të korrespondojë shumës së raportuar në bilanc (nëse në bilanc raportohet në mënyrë të veçantë).
1.1.1.9.2	Detyrimet e shtyra tatimore të lidhura me aktivet e fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar		Neni 15, paragrafi 2, shkronja “a”: Shuma e detyrimeve tatimore të shtyra që do të fshihej nëse aktivet e fondit të pensionit me përfitim të përcaktuar do të zhvlerësoheshin ose fshiheshin sipas standardeve kontabël.
1.1.1.9.3	Aktive të fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar, të cilat institucioni ka aftësi të pakufizuar për t'i përdorur		Neni 15, paragrafi 2, shkronja “b”: Ky zë do të plotësohet vetëm nëse është marrë miratimi paraprak nga Banka e Shqipërisë për të zvogëluar shumën e aktiveve të fondit të pensionit me përfitim të përcaktuar. Aktivet e përfshira në këtë rresht do të ponderohen me një peshë me rrezik sipas kërkesave të rregullores për mjaftueshmërinë e kapitalit.
1.1.1.10	(-) Pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara në KBN1		Neni 11, paragrafi 1, shkronja “f” dhe neni 17: Pjesëmarrjet në instrumente financiare të KBN1 të subjekteve të sektorit financiar ku ka një pjesëmarrje reciproke të kryqëzuar të cilën Banka e



			Shqipërisë e konsideron si të krijuar për të fryrë artificialisht kapitalin rregullator të bankës. Shuma që do të raportohet do të përlogaritet në bazë të pozicioneve bruto në blerje dhe do të përfshijë zërat e sigurimit (insurance items) të kapitalit bazë.
1.1.1.11	(-) Teprica e zbritjeve nga zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë që tejkalojnë kapitalin bazë të nivelit të parë	(-1.1.2.6)	Neni 11, paragrafi 1, shkronja “i”: Shuma që do të raportohet në këtë rresht merret drejtpërdrejt nga rreshti 610 “Teprica e zbritjes nga zërat AT1 mbi kapitalin AT1. Shuma duhet të zbritet nga KBN1.
1.1.1.12	(-) Pjesëmarrjet influencuese (qualifying holdings) jashtë sektorit financiar të cilat (në mënyrë alternative) mund të jenë subjekt i një peshe me rrezik prej 1250%		Neni 11, paragrafi 1, shkronja “j”, nënpika (i): Sipas nenit 11, paragrafi 1, shkronja “j”, pjesëmarrjet influencuese (qualifying holdings) mund të zbriten nga Kapitali Bazë i Nivelit të Parë (duke i raportuar në këtë rresht) ose të ponderohen me 1250%.
1.1.1.13	(-) Pozicionet e titullzimit të cilat (në mënyrë alternative) mund të jenë subjekt i një peshe me rrezik prej 1250%		Neni 11, paragrafi 1, shkronja “j”, nënpika (ii): Pozicionet e titullzimit që janë subjekt i ponderimit me një peshë rreziku prej 1250%, por në mënyrë alternative lejohen të zbriten nga Kapitali Bazë i Nivelit të Parë. Në rast se zbriten, do të raportohen në këtë rresht.
1.1.1.14	(-) Transaksione joDVP (free delivery) të cilat (në mënyrë alternative) mund të jenë subjekt i një peshe me rrezik prej 1250%		Neni 11, paragrafi 1, shkronja “j”, nënpika (iii): Transaksionet me dorëzim të lirë janë subjekt i ponderimit me 1250% 5 ditë pas pagesës së dytë kontraktuale ose këmbës së dorëzimit deri në shuarjen e transaksionit, sipas kërkesave të RMK për rrezikun e shlyerjes. Në mënyrë alternative ato mund të zbriten nga Kapitali Bazë i Nivelit të Parë dhe të raportohen në këtë rresht.
1.1.1.15	(-) Instrumente të KBN1 të subjekteve të sektorit financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 11, paragrafi 1, shkronja “g” dhe neni 18: Pjesa e pjesëmarrjeve të bankës në instrumente kapitali të subjekteve të sektorit financiar ku banka nuk ka investimet e rëndësishme, që duhet zbritur nga Kapitali Bazë i Nivelit të Parë.
1.1.1.16	(-) Aktive tatimore të shtyra të zbritshme që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme		Neni 11, paragrafi 1, shkronja “c”, neni 13 dhe neni 20, paragrafi 1, shkronja “a”: Pjesa e aktiveve tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme (neto nga pjesa e detyrimeve tatimore shoqëruese që i alokohen aktiveve tatimore të shtyra që burojnë nga diferencat e përkohshme, në përputhje me nenin 13, paragrafi 4, shkronja “b”) që duhet të zbritet, duke zbatuar kufirin prej 10% të specifikuar në nenin 20, paragrafi 1, shkronja “a”.
1.1.1.17	(-) Instrumente të KBN1 të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 11, paragrafi 1, shkronja “h”, neni 19, neni 20, paragrafi 1, shkronja “b”, Pjesa e pjesëmarrjeve të bankës në instrumente të Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investime të rëndësishme që duhet të zbritet, duke zbatuar kufirin prej 10% të specifikuar në nenin 20, paragrafi 1, shkronja “b”.
1.1.1.18	(-) Shuma që tejkalon kufirin prej 17.65%		Neni 20, paragrafi 1: Pjesa e aktiveve tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme, dhe pjesëmarrjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të bankës në instrumentet e Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimet e rëndësishme që duhet të zbritet, duke zbatuar kufirin prej 17.65% të specifikuar në nenin 20, paragrafi 1.
1.1.2	KAPITALI SHITESË I NIVELIT TË PARË	1.1.2.1 + 1.1.2.2 + 1.1.2.3 + 1.1.2.4 + 1.1.2.5 + 1.1.2.6 + 1.1.2.7 + 1.1.2.8	Neni 21
1.1.2.1	Instrumentet e kapitalit të njohura si kapital shtesë i nivelit të parë	1.1.2.1.1 + 1.1.2.1.3 + 1.1.2.1.4 + 1.1.2.1.5	Neni 21, paragrafi 1, shkronja “a”; Neni 21, paragrafi 2; nenet 22-24; Neni 25 shkronja “a” dhe neni 26
1.1.2.1.1	Instrumente kapitali të paguara		Neni 21, paragrafi 1, shkronja “a”; Neni 21, paragrafi 2; nenet 22-24; Shuma që do raportohet nuk do të përfshijë Primet e emetimit të lidhura me instrumentet.
1.1.2.1.2	Zë memorandumi: Instrumente kapitali jo të njohura		Neni 22, paragrafi 1, shkronja “c”, “e” dhe “f”. Kushtet në këto pika pasqyrojnë situata të ndryshme të kapitalit, të cilat janë të kthyeshme, ndaj shuma e raportuar këtu mund të të njihet në periudhat pasuese. Shuma që do raportohet nuk do të përfshijë primet e emetimit të lidhura me instrumentet.
1.1.2.1.3	Primet e emetimit të lidhura me instrumentet		Neni 21, paragrafi 1, shkronja “b”. Primet e emetimit të lidhura me instrumentet kanë të njëjtin kuptim sipas standardeve kontabël. Shuma që do të raportohet do të jetë pjesë e lidhur me instrumente kapitali të paguara.



1.1.2.1.4	(-) Instrumentet e veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë	1.1.2.1.4.1 + 1.1.2.1.4.2 + 1.1.2.1.4.3	Neni 22, paragrafi 1, shkronja “b”; neni 25, shkronja “a” dhe neni 26. Shuma që do të raportohet do të përfshijë primet e emetimit të lidhura me instrumentet që lidhen me instrumentet e veta.
1.1.2.1.4.1	(-) Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë		Neni 22, paragrafi 1, shkronja “b”; neni 25, shkronja “a” dhe neni 26.
1.1.2.1.4.2	(-) Pjesëmarrjet të tërthorta në instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë		Neni 22, paragrafi 1, shkronja “b” pika “i”; neni 25, shkronja “a” dhe neni 26.
1.1.2.1.4.3	(-) Pjesëmarrjet sintetike në instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë		Neni 22, paragrafi 1, shkronja “b”; neni 25, shkronja “a” dhe neni 26.
1.1.2.1.5	(-) Detyrime aktuale ose të mundshme për të blerë instrumente të veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë		Neni 25, shkronja “a” dhe neni 26. Sipas neni 25, shkronja “a”, “instrumente të veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë, të cilat banka është e detyruar t'i blejë si rezultat i një detyrimi kontraktual” duhet të zbriten.
1.1.2.2	(-) pjesëmarrjet reciproke (të kryqëzuara) në kapitalin shtesë të nivelit të parë (AT1)		Neni 25, shkronja “b” dhe neni 27. Pjesëmarrje në instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar kur ka pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) me bankën, të cilat Banka e Shqipërisë vlerëson se janë krijuar për të rritur artificialisht kapitalin e bankës.
1.1.2.3	(-) Instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1) të subjekteve të sektorit financiar, ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 25, shkronja “c”; neni 28; neni 29; neni 40. Pjesëmarrje në instrumente të subjekteve të sektorit financiar, ku banka nuk ka investime të rëndësishme të cilat duhet të zbriten nga kapitali shtesë i nivelit të parë (AT1).
1.1.2.4	(-) Instrumente e kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1) të subjekteve të sektorit financiar, ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 25, shkronja “d”; neni 28; neni 40. Pjesëmarrjet në instrumentet të kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1) të subjekteve të sektorit financiar, ku banka ka investime të rëndësishme, zbriten plotësisht.
1.1.2.5	(-) tepricat e zbritjeve nga zërat e kapitalit të nivelit të dytë (T2) që tejkalojnë kapitalin e nivelit të dytë (T2)	(-1.2.6)	Neni 25, shkronja “e”. Shuma që do të raportohet do të merret direkt në zërin “Tepricat e zbritjeve nga zërat e kapitalit të nivelit të dytë (T2) që tejkalojnë kapitalin e nivelit të dytë (T2)” (e zbritur në AT1)
1.1.2.6	Tepricat e zbritjeve nga zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1) që tejkalojnë kapitalin shtesë të nivelit të parë (AT1) (të zbritura në kapitalin bazë të nivelit të parë CET1)		Neni 11, shkronja “i”. Kapitali shtesë i nivelit të parë (AT1) nuk mund të jetë negativ, por është e mundur që zbritjet nga AT1 të jenë më të mëdha se kapitali i AT1 plus Primet e emetimit të lidhura me instrumentet që lidhen me to. në rastet kur ndodh kjo, atëherë AT1 duhet të barazohet me zero, dhe tepricat e zbritjeve nga AT1 duhet të zbriten nga KBN1.
1.1.2.7	(-) Zbritjet shtesë të kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1)		Kjo rregullore nuk pengon bankat për të mbajtur më tepër kapital rregullator apo të aplikojë masa më të repta nga sa parashikohen në këtë rregullore.
1.1.2.8	Elemente të kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1) ose zbritje - të tjera		Ky rresht është vendosur për të siguruar fleksibilitet dhe për qëllime raportimi. Rreshti do të plotësohet vetëm në raste të rralla nëse elementet e kapitali shtesë të nivelit të parë (AT1) apo zbritjet të elementeve të kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1) nuk do të caktoheshin në rreshtat nga 1.1.2 (kapitali shtesë i nivelit të parë) deri tek rreshti 1.1.2.7 (Zbritjet shtesë të kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1))
1.2	KAPITALI I NIVELIT TË DYTË	1.2.1 + 1.2.2 + 1.2.3 + 1.2.4 + 1.2.5 + 1.2.6 + 1.2.7 + 1.2.8	Neni 30
1.2.1	Instrumentet e kapitalit dhe borxhi i varur të njohur si kapital i nivelit të dytë	1.2.1.1 + 1.2.1.3 + 1.2.1.4 + 1.2.1.5	Neni 30, paragrafi 1, shkronja “a”; neni 31; neni 33, shkronja “a” dhe neni 34.
1.2.1.1	Instrumente të kapitalit të paguara plotësisht dhe borxhi i varur		Neni 30, paragrafi 1, shkronja “a”; neni 31. Shuma që do të raportohet nuk do të përfshijë primet e emetimit të lidhura me instrumentet.
1.2.1.2	Zëra memorandum: Instrumentet e kapitalit dhe borxhi i varur jo i njohur		Neni 31, paragrafi 1, shkronja “c”, “e” dhe “f”. Kushtet në këto pika pasqyrojnë situata të ndryshme të kapitalit, të cilat janë të kthyeshme, ndaj shuma e raportuar këtu mund të të njihet në periudhat pasuese. Shuma që do të raportohet nuk do të përfshijë primet e emetimit të lidhura me instrumentet.
1.2.1.3	Primet e emetimit të lidhura me instrumentet		Neni 30, paragrafi 1, shkronja “b”. Primet e emetimit të lidhura me instrumentet kanë të njëjtin kuptim sipas standardeve kontabël. Shuma që do të raportohet do të jetë pjesë e lidhur me instrumente kapitali të paguara.
1.2.1.4	(-) Instrumentet e veta të kapitalit të nivelit të dytë (T2)	1.2.1.4.1 + 1.2.1.4.2 + 1.2.1.4.3	Neni 31, shkronja “b”, pika (i); neni 33, shkronja “a” dhe neni 34. Shuma që do të raportohet në këtë rresht do të përfshijë primet e emetimit të lidhura me instrumentet që lidhen me instrumentet e veta.



1.2.1.4.1	(-) Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta të instrumenteve të kapitalit të nivelit të dytë (T2)	Neni 31, shkronja “b”; neni 33, shkronja “a” dhe neni 34.
1.2.1.4.2	(-) Pjesëmarrjet e tërthorta të instrumenteve të kapitalit të nivelit të dytë (T2)	Neni 31, shkronja “b”; neni 33, shkronja “a” dhe neni 34.
1.2.1.4.3	(-) Pjesëmarrjet sintetike të instrumenteve të kapitalit të nivelit të dytë (T2)	Neni 31, shkronja “b”; neni 33, shkronja “a” dhe neni 34.
1.2.1.5	(-) Detyrim aktual apo i mundshëm për të blerë instrumentet e veta të kapitalit të nivelit të dytë (T2)	Neni 33, shkronja “a” dhe neni 34.
1.2.2	Metoda standarde (SA) rregullimet kryesore të rrezikut të kredisë	
1.2.3	(-) Pjesëmarrje të kryqëzuara (reciproke) në kapitalin e nivelit të dytë (T2)	Neni 33, shkronja “b” dhe neni 35.
1.2.4	(-) Instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë T2 të subjekteve të sektorit financiar, ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme	Neni 33, shkronja “c”; neni 35; neni 36; neni 37 dhe neni 40.
1.2.5	(-) Instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë T2 të subjekteve të sektorit financiar, ku banka ka investimeve të rëndësishme	Neni 33, shkronja “d”; neni 35; neni 36 dhe neni 40.
1.2.6	Tepërcat e zbritjeve nga zërat e kapitalit të nivelit të dytë (T2) që tejkalojnë kapitalin e nivelit të dytë (T2)	Neni 25, shkronja “e”. Kapitali i nivelit të dytë (T2) nuk mund të jetë negativ, por është e mundur që zbritjet nga T2 të jenë më të mëdha se kapitali i T2 plus primet e emetimit të lidhura me instrumentet që lidhen me to. në rastet kur ndodh kjo, atëherë T2 duhet të barazohet me zero, dhe tepërcat e zbritjeve nga T2 duhet të zbriten nga AT1.
1.2.7	(-) Zbritjet shtesë të kapitalit të nivelit të dytë (T2)	Kjo rregullore nuk pengon bankat për të mbajtur më tepër kapital rregullator apo të aplikojë masa më të rrepta nga sa parashikohen në këtë rregullore.
1.2.8	Elemente të kapitalit të dytë (T2) ose zbritje - të tjera	Ky rresht është vendosur për të siguruar fleksibilitet dhe për qëllime raportimi. Rreshti do të plotësohet vetëm në raste të rralla nëse nuk ka një vendimarrje finale në raportimin e zerave/zbritjeve specifike të kapitalit. Rreshti do të plotësohet vetëm nëse elementet e kapitali të nivelit të dytë (T2) apo zbritje të elementeve të kapitalit të nivelit të dytë (T2) nuk do të caktoheshin në rreshtat nga 1.2 (kapitali i nivelit të dytë) deri tek rreshti 1.2.7 (Zbritjet shtesë të kapitalit të nivelit të dytë (T2))

RAPORTET DHE NIVELET E KAPITALIT

NR.	Zëra	Vlera
1	Raporti: Kapitali bazë i nivelit të parë/ekspozime të ponderuara me rrezikun	≥ 4.5%
3	Raporti: Kapitali i nivelit të parë/ekspozime të ponderuara me rrezikun	≥ 6%
5	Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	≥ 12%



ZERA MEMORANDUMI			
NR.	Zëri	Shuma	Udhëzues
	Aktive dhe pasive tatimore të shtyra		
1	Totali i aktiveve tatimore të shtyra		Shuma e raportuar në këtë rresht do të jetë e barabartë me shumën e raportuar në bilanci kontabël të bankës.
1.1	Aktive tatimore të shtyra të cilat nuk varen nga përfitueshmëria në të ardhmen		Neni 14: Aktivët tatimore të shtyra që nuk varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe janë subjekt i aplikimit të një peshe të caktuar me rrezik.
1.2	Aktive tatimore të shtyra të cilat varen nga përfitueshmëria në të ardhmen dhe nuk burojnë nga diferenca të përkohshme		Neni 11, paragrafi 1, shkronja “c”, dhe neni 13: Aktivët tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme por nuk burojnë nga diferenca të përkohshme, dhe nuk janë subjekt i ndonjë zbritjeje kufi (pra zbriten plotësisht nga Kapitali Bazë i Nivelit të Parë).
1.3	Aktive tatimore të shtyra të cilat varen nga përfitueshmëria në të ardhmen dhe burojnë nga diferenca të përkohshme		Neni 11, paragrafi 1, shkronja “c”, neni 13, dhe neni 20, paragrafi 1, shkronja “a”: Aktivët tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferenca të përkohshme, dhe si rezultat zbritja e tyre nga Kapitali Bazë i Nivelit të Parë do të jetë subjekt i kufijve prej 10% dhe 17.65% të përcaktuar në nenin 20.
2	Totali i pasiveve tatimore të shtyra	2.1+2.2	Shuma e raportuar në këtë rresht do të jetë e barabartë me shumën e raportuar në bilanci kontabël të bankës.
2.1	Pasive tatimore të shtyra jo të zbritshme nga aktivët tatimore të shtyra të cilat varen nga përfitueshmëria në të ardhmen		Neni 13, paragrafi 2 dhe 3: Detyrimet tatimore të shtyra për të cilat kushtet në nenin 13, paragrafi 2 dhe 3 nuk përmbushen. Në këtë rresht do të përfshihen detyrimet tatimore të shtyra që reduktojnë shumën e emrit të mirë, aktiveve të tjera të patrupëzuara ose aktiveve të fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar që duhet të zbriten.
2.2	Pasive tatimore të shtyra të zbritshme nga aktivët tatimore të cilat varen nga përfitueshmëria në të ardhmen		Neni 13
2.2.1	Pasive tatimore të shtyra të zbritshme që kanë lidhje me aktive tatimore të shtyra të cilat varen nga përfitueshmëria në të ardhmen dhe nuk burojnë nga diferenca të përkohshme		Neni 13, paragrafi 2, 3 dhe 4: Aktivët tatimore të shtyra që mund të reduktojnë shumën e aktiveve tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme, sipas nenit 13, paragrafi 2 dhe 3, dhe nuk janë alokuar tek aktivët tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferenca të përkohshme sipas nenit 13, paragrafi 4.
2.2.2	Pasive tatimore të shtyra të zbritshme që kanë lidhje me aktive tatimore të shtyra të cilat varen nga përfitueshmëria në të ardhmen dhe burojnë nga diferenca të përkohshme		Aktivët tatimore të shtyra që mund të reduktojnë shumën e aktiveve tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme, sipas nenit 13, paragrafi 2 dhe 3, dhe janë alokuar tek aktivët tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferenca të përkohshme sipas nenit 13, paragrafi 4.
8	Kufiri i pazbritshëm i pjesëmarrjeve në subjektet e sektorit financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 18, paragrafi 4, shkronja “a”: Në këtë rresht raportohet kufiri deri në të cilin pjesëmarrjet në një subjekt të sektorit financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme, nuk zbriten. Pra shuma do të përfshijë zërat që janë në bazë të kufirit shumëzuar me 10%.
9	Kufiri 10% i Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë		Neni 20, paragrafi 1, shkronjat “a” dhe “b”: Në këtë rresht raportohet kufiri 10% për pjesëmarrjet në subjektet e sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme, dhe për aktivët tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferenca të përkohshme. Shuma përfshin zërat që janë në bazë të kufirit, shumëzuar me 10%.
10	Kufiri 17.65% i Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë		Neni 20, paragrafi 1: Në këtë rresht raportohet kufiri 17.65% për pjesëmarrjet në subjektet e sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme, dhe për aktivët tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferenca të përkohshme, që zbatohet pas kufirit prej 10%. Kufiri përlogarit në mënyrë të tillë që shuma e dy zërave që njihet të mos tejkalojë 15% të Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë, të përlogaritur pas gjithë zbritjeve.
	Investimet në kapitalin e subjekteve të sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		
12	Pjesëmarrje në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë të subjekteve të sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme, të netuara me pozicionet në shitje		Neni 17 dhe neni 18
12.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe neni 18



12.1.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta (BRUTO) në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë të subjekteve të sektorit financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme duke përfshirë: a) Pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për 5 ditë punë ose më pak; b) Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara sipas nenit 11, paragrafi 1, shkronja “f”.
12.1.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 18, paragrafi 2 dhe 3: Kompensimi i pozicioneve në shitje me pozicionet në blerje, lejohet kur këto janë në të njëjtin ekspozim themelor dhe maturiteti i pozicionet në shitje përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose ka një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
12.2	Pjesëmarrje të tërthorta në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe Neni 18, paragrafi 2 dhe 3
12.2.1	Pjesëmarrje të tërthorta (BRUTO) në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe Neni 18, paragrafi 2 dhe 3: Shuma që do të raportohet përfaqëson pjesëmarrjet e tërthorta në librin e tregtueshëm të instrumenteve të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar që kanë formën e pjesëmarrjeve në letra me vlerë të indekseve. Kjo shumë përfshihet duke përfshirë ekspozimin themelor ndaj instrumenteve të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në këto indekse. Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje të kryqëzuara reciproke sipas nenit 11, paragrafi 1, shkronja “f” nuk do të përfshihen.
12.2.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e tërthorta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 18, paragrafi 2: Neni 18, paragrafi 2 lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëjtin ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
12.3	Pjesëmarrje sintetike në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe neni 18 paragrafi 2 dhe 3
12.3.1	Pjesëmarrje sintetike (BRUTO) në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe neni 18 paragrafi 2 dhe 3
12.3.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet sintetike (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 18 paragrafi 2 dhe 3
13	Pjesëmarrje në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme, të netuara me pozicionet në shitje	13.1+13.2+13.3	Neni 27; neni 28 dhe neni 29.
13.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme	13.1.1+13.1.2	Neni 27; neni 28 dhe neni 29, paragrafi 2.
13.1.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta (BRUTO) në kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 27 dhe neni 29, paragrafi 2. Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar, ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme, duke përfshirë: a) pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për pesë ditë punë ose më pak; dhe b) pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) sipas nenit 25, shkronja “b”
13.1.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 28
13.2	Pjesëmarrje të tërthorta në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme	13.2.1+13.2.2	Neni 27 dhe neni 28.
13.2.1	Pjesëmarrje të tërthorta (BRUTO) në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 27 dhe neni 28. Shuma që do të raportohet përfaqëson pjesëmarrjet e tërthorta në librin e tregtueshëm të instrumenteve të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar që kanë formën e pjesëmarrjeve në letra me vlerë të indekseve. Kjo shumë përfshihet duke përfshirë ekspozimin themelor ndaj instrumenteve të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në këto indekse. Pjesëmarrjet që janë trajtuar si pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) sipas nenit 25, shkronja “b” nuk do të përfshihen.
13.2.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e tërthorta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 28. Neni 25, shkronja “a” lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëjtin ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
13.3	Pjesëmarrje sintetike në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme	13.3.1+13.3.2	Neni 27 dhe neni 28.
13.3.1	Pjesëmarrje sintetike (BRUTO) në kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 27 dhe neni 28.
13.3.2	(-) Kompensimet e lejuara në pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet sintetike (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 28.



14	Pjesëmarrje në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme, të netuara me pozicionet në shitje	14.1+14.2+14.3	Neni 35; neni 36 dhe neni 37.
14.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme	14.1.1+14.1.2	Neni 35; neni 36 dhe neni 37, paragrafi 2.
14.1.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta (BRUTO) në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 35 dhe neni 37, paragrafi 2. Pjesëmarrje të drejtpërdrejta në kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar, ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme, duke përfshirë: a) pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për pesë ditë pune ose më pak; dhe b) pjesëmarrje që trajtohen si pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) sipas nenit 33, shkronja “b”
14.1.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicione në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrje të drejtpërdrejta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 36. Neni 36, shkronja “a” lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëjtën ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
14.2	Pjesëmarrje të tërthorta në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve e në sektorin financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme	14.2.1+14.2.2	Neni 35 dhe neni 36.
14.2.1	Pjesëmarrje të tërthorta (BRUTO) në kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 35 dhe neni 36. Shuma që do të raportohet përfaqëson pjesëmarrjet e tërthorta në librin e tregtueshëm të instrumenteve të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar që kanë formën e pjesëmarrjeve në letra me vlerë të indekseve. Kjo shumë përfshihet duke përllogaritur ekspozimin themelor ndaj instrumenteve të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në këto indekse. Pjesëmarrjet që janë trajtuar si pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) sipas nenit 33, shkronja “b” nuk do të përfshihen.
14.2.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicione në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e tërthorta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 36. Neni 36, shkronja “a” lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëjtën ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit
14.3	Pjesëmarrje sintetike në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme	14.3.1+14.3.2	Neni 35 dhe neni 36.
14.3.1	Pjesëmarrje sintetike (BRUTO) në kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 35 dhe neni 36.
14.3.2	(-) Kompensimet e lejuara në pozicione në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet sintetike (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 36.
Pjesëmarrje në Kapitalin e subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme			
15	Pjesëmarrje në Kapitalin bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme	15.1+15.2+15.3	Neni 17 dhe neni 19
15.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta në Kapitalin bazë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme	15.1.1+15.1.2	Neni 17 dhe neni 19
15.1.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta (BRUTO) në Kapitalin bazë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe neni 19: Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme, duke përfshirë: a) Pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për 5 ditë pune ose më pak; b) Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara
15.1.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 19, paragrafi 4 dhe 5: Kompensimi i pozicioneve në shitje për të njëjtën ekspozim themelor mund të kryhet nëse maturiteti i pozicionit në shitje përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose ka një maturitet të mbetur prej të paktën një viti.
15.2	Pjesëmarrje të tërthorta në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme	15.2.1+15.2.2	Neni 17 dhe neni 19, paragrafi 4 dhe 5
15.2.1	Pjesëmarrje të tërthorta (BRUTO) në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe neni 19, paragrafi 4 dhe 5: Shuma që do të raportohet do të përfaqësojë pjesëmarrjet indirekte në librin e tregtueshëm të instrumenteve të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar që kanë formën e pjesëmarrjeve në letra me vlerë të indekseve. Kjo shumë do të përfshihet duke përllogaritur ekspozimin themelor ndaj instrumenteve të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në indekse. Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara sipas nenit 11, paragrafi 1, shkronja “P” nuk do të përfshihen.
15.2.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e tërthorta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 19, paragrafi 4 dhe 5: Kompensimi i pozicioneve në shitje për të njëjtën ekspozim themelor mund të kryhet nëse maturiteti i pozicionit në shitje përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose ka një maturitet të mbetur prej të paktën një viti.
15.3	Pjesëmarrje sintetike në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit	15.3.1+15.3.2	Neni 17 dhe neni 19, paragrafi 4 dhe 5



	financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme		
15.3.1	Pjesëmarrje sintetike (BRUTO) në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe neni 19, paragrafi 4 dhe 5
15.3.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet sintetike (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 19, paragrafi 4 dhe 5
16	Pjesëmarrje në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme, të netuara me pozicionet në shitje	16.1+16.2+16.3	Neni 27 dhe neni 28.
16.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme	16.1.1+16.1.2	Neni 27 dhe neni 28.
16.1.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta (BRUTO) në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 27. Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në kapitalin shtesë të Nivelit të Parë (AT1) të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme, duke përjashtuar: a) Pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për 5 ditë punë ose më pak (neni 25, shkronja “d”); b) Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara sipas nenit 25, shkronja “b”
16.1.2	(-)Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 28, shkronja “a” lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëtin ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
16.2	Pjesëmarrje të tërthorta në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme	16.2.1+16.2.2	Neni 27 dhe neni 28.
16.2.1	Pjesëmarrje të tërthorta (BRUTO) në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 27 dhe neni 28. Shuma që do të raportohet do të përfaqësojë pjesëmarrjet indirekte në librin e tregtueshëm të instrumenteve të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar që kanë formën e pjesëmarrjeve në letra me vlerë të indekseve. Kjo shumë do të përftohet duke përllogaritur ekspozimin themelor ndaj instrumenteve të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në indekse. Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara sipas nenit 25, shkronja “b” nuk do të përfshihen.
16.2.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e tërthorta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 28, shkronja “a” lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëtin ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
16.3	Pjesëmarrje sintetike në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme	16.3.1+16.3.2	Neni 27 dhe neni 28.
16.3.1	Pjesëmarrje sintetike (BRUTO) në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 27 dhe neni 28.
16.3.2	(-) Kompensimet e lejuara në pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet sintetike (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 28.
17	Pjesëmarrje në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme, të netuara me pozicionet në shitje	17.1+17.2+17.3	Neni 35 dhe neni 36.
17.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme	17.1.1+17.1.2	Neni 35 dhe neni 36.
17.1.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta (BRUTO) në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 35, Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në kapitalin e Nivelit të Dytë (T2) të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme, duke përjashtuar: a) Pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për 5 ditë punë ose më pak (neni 33, shkronja “d”); b) Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara sipas nenit 33, shkronja “b”
17.1.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicione në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 36, shkronja “a” lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëtin ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
17.2	Pjesëmarrje të tërthorta në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve e në sektorin financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme	17.2.1+17.2.2	Neni 35 dhe neni 36.
17.2.1	Pjesëmarrje të tërthorta (BRUTO) në kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 35 dhe neni 36. Shuma që do të raportohet do të përfaqësojë pjesëmarrjet indirekte në librin e tregtueshëm të instrumenteve të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar që kanë formën e pjesëmarrjeve në letra me vlerë të indekseve. Kjo shumë do të përftohet duke përllogaritur ekspozimin themelor ndaj instrumenteve të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në indekse. Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara sipas nenit 33, shkronja “b” nuk do të përfshihen.



17.2.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicione në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e tërthorta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 36, shkronja “a”, lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëtin ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
17.3	Pjesëmarrje sintetike në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme	17.3.1+17.3.2	Neni 35 dhe neni 36.
17.3.1	Pjesëmarrje sintetike (BRUTO) në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 35 dhe neni 36.
17.3.2	(-) Kompensimet e lejuara në pozicione në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet sintetike (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 36.
Shuma totale e rrezikut të ekspozimit të pjesëmarrjeve - që nuk janë zbritur nga kategoria korresponduese e kapitalit			
18	Ekspozimet e pjesëmarrjeve në Kapitalin bazë të nivelit të parë të ponderuara për rrezikun në subjektet e sektorit financiar të cilat nuk janë të zbritura nga Kapitali bazë i nivelit të parë të bankës		Neni 18.
19	Ekspozimet e pjesëmarrjeve në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të ponderuara për rrezikun në subjektet e sektorit financiar të cilat nuk janë të zbritura nga Kapitali shtesë i nivelit të parë të bankës		Neni 29.
20	Ekspozimet e pjesëmarrjeve në Kapitalin të nivelit të dytë të ponderuara për rrezikun në subjektet e sektorit financiar të cilat nuk janë të zbritura nga Kapitali i nivelit të dytë të bankës		Neni 37.

**VENDIM****Nr. 70, datë 18.12.2014****PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “PËR RAPORTIN E
MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe neni 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 58, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, nenit 59, pikat 2 dhe 3, dhe të nenit 60, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.7.2013, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 6, pas paragrafit 1, shtohen paragrafët 2, 3, 4 dhe 5, me përmbajtjen e mëposhtme:

“2) Pavarësisht përcaktimeve në paragrafin 1 të këtij neni, banka rregullon totalin e aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezikun, siç përcaktohet më poshtë:

a) duke e shtuar me vlerën e rritjes, që rezulton në krahasim me muajin mars 2013, të klasave në aktiv të bilancit “veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “veprime në valutë me tituj” me jorezidentët pasi të jetë zbritur vlera e shtuar e detyrimeve ndaj jorezidentëve në valutë, që u përkasin të njëjtave klasa në atë periudhë raportuese;

b) për vitin 2015, duke e pakësuar me vlerën që rezulton nga një prej dy llogaritjeve të mëposhtme:

i) vlerën e rritjes së tepricës bruto të kredisë për klientët⁵, të akorduar brenda vendit, në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, në krahasim me muajin dhjetor 2014, në rast se kjo rritje është më e madhe se 4 (katër) % dhe më e vogël ose e barabartë me 10 (dhjetë) %;

ii) vlerën 10 (dhjetë) % të tepricës bruto të kredisë për klientët të akorduar brenda vendit, në krahasim me muajin dhjetor 2014, në rast se rritja në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, është më e madhe se 10 (dhjetë) %.

3) Përlllogaritjet sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b” të paragrafit 2 bëhen sipas formularit 1 dhe 2, aneksi 8 bashkëlidhur këtij vendimi.

4) Shkronja “a” e paragrafit 2 të këtij neni është në fuqi deri në datën 1 janar 2016, ndërsa shkronja “b” e paragrafit 2 të këtij neni është në fuqi deri në datën 1 korrik 2015.

5) Në përfundim të afateve të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, nëse banka nuk respekton nivelin minimal të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje ose përcaktimeve të tjera të Bankës së Shqipërisë, banka merr masa për të respektuar këto kërkesa brenda një afati i cili i komunikohet nga Banka e Shqipërisë.”.

b) Në “aneksin 7”, ndryshohet formulari 9 me përmbajtjen sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.

c) Pas “aneksit 7”, shtohet “aneksi 8” që përmban formularin e raportimit nr. 1 dhe formularin e raportimit nr. 2, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.

d) Efektet e paragrafëve 2, 3, 4 dhe 5, të nenit 6, do të fillojnë të llogariten nga data 31 dhjetor 2014.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Stabiliteti Financiar e i Statistikave me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Elisabeta Gjoni

⁵ Sipas Sistemit Raportues të Unifikuar, përfshihen: “Individët”, “Njësitë tregtare dhe industriale private”, “Njësitë tregtare dhe industriale publike”, “Punonjësit e bankës” dhe “Klientë të tjerë”.



FORMULARI 9

RMK - Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

1)

Treguesit	Vlera
Kapitali rregullator	(a)
Aktivët dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	(b)
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (në %)	$(a)/(b)*100$

2)

Treguesit	Vlera
Aktivët dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	$(d) = (a) + (b) + (c) + (d) - (e)$
Aktivët dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë	(a)
12.5*kerkesa për kapital për rrezikun e tregut	(b)
12.5*kerkesa për kapital për rrezikun operacional	(c)
Shtesat për rritjen në klasat në "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë	(d)
Pakësimet për rritjen e portofolit të kredisë brenda vendit për vitin 2015	(e)

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 1

Llogaritja e rritjes së totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik, bazuar në klasat "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë" jorezidente në valutë
(në mijë lekë)
Emri i bankës
Periudha raportuese
Data e raportimit
Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)
Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

Nr.	Llogaritja e rritjes së totalit të aktiveve të ponderuar me rrezik, bazuar në klasat "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë", të jorezidentëve në valutë	Mënyra e llogaritjes
1.	Totali i zërave të aktivitetit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë, mars 2013	(a)
2.	Totali i zërave të aktivitetit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë", jorezidente në valutë në periudhën raportuese	(b)
3.	Rritja e zërave të aktivitetit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksioneve ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë	$(c) = (b) - (a)$
4.	Totali i zërave të pasivitetit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë, mars 2013	(d)
5.	Totali i zërave të pasivitetit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksioneve ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë, në periudhën raportuese	(e)



6	Rritja e zërave të pasivit i “Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “Veprimeve me letrat me vlerë” të jorezidentëve, në valutë	$(f) = (e) - (d)$
7.	Shtesa e totalit të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	$(g) = 0$ nëse $(c) \leq 0$ ose $(c) < (f)$; $(g) = (c)$ nëse $(f) < 0$ $(g) = (c) - (f)$ nëse $(c) > 0$ dhe $(f) > 0$

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 2

Nr.	Llogaritja e pakësimit të totalit të aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik, bazuar në rritjen e portofolit të kredisë bruto brenda vendit	Mënyra e llogaritjes
1.	Portofoli i kredisë bruto, në dhjetor 2014	(a)
2.	Portofoli i kredisë bruto, në periudhën raportuese 2015	(b)
3.	Rritja e portofolit të kredisë, 2015	$(c) = (b) - (a)$
4.	Rritja e portofolit të kredisë për 2015-ën, me bazë vjetore, sipas periudhës raportuese: - nëse periudha raportuese është mars 2015; - nëse periudha raportuese është qershor, 2015	$(d) = (c) * 4$; $(d) = (c) * 2$;
5.	4% e portofolit të kredisë së dhjetorit 2014	$(e) = (a) * 4\%$
6.	10% e portofolit të kredisë së dhjetorit 2014	$(f) = (a) * 10\%$
7.	Pakësimi i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik, vetëm për periudhën raportuese 2015	$(g) = 0$ nëse $(d) < (e)$; $(g) = (d)$ nëse $(e) < (d) < (f)$; $(g) = (f)$ nëse $(d) > (f)$

**Korrigjim gabimi**

Në udhëzimin nr. 31, datë 29.12.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 206, datë 8 janar 2015, në faqen 12451, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Në paragrafin e tretë të pikës 24 të udhëzimit, e cila ndryshon pikën 5.5, togfjalëshi “**brenda datës 20 dhjetor të periudhës tatimore**”, të zëvendësohet me togfjalëshin “**brenda datës 20 janar të vitit pasardhës**”.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja "Kristalina"
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 273 lekë